




USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



DEMOCRACY PLUS



Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve në Gjykatat Themelore të Kosovës

Sondazhi me përdoruesit e gjykatave

Qershor 2018

VLERËSIMI I CILËSISË SË SHËRBIMEVE NË GJYKATAT THEMELORE TË KOSOVËS

SONDAZHI ME PËRDORUESIT E GJYKATËS

Prishtinë, qershor 2018

Mohim i përgjegjësisë

Ky raport është mundësuar me mbështetjen e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Democracy Plus dhe jo domosdoshmërisht reflekton këndvështrimet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

Autore: Roberta Osmani

Mohim i përgjegjësive

Ky publikim është përgatitur nga Democracy Plus. Këndvështrimet e shprehura në këtë publikim jo domosdoshmërisht reflektojnë këndvështrimet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar (USAID) apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

PËRMBAJTJA

1	HYRJE.....	5
2	Metodologjia e Hulumtimit.....	6
2.1	Variablat e studiuara.....	6
2.1.1	Qasja në Informata Publike.....	6
2.1.2	Efikasiteti.....	6
2.1.3	Korrupsioni.....	6
2.2	Anketa.....	6
2.2.1	Të dhënat demografike.....	8
2.2.2	Arsyeja pse respondentët kanë ardhur në gjykatë.....	10
2.3	DISKUTIMET NË FOKUS GRUPE.....	12
3	cilësia e shërbimeve në gjykata.....	13
4	Të gjeturat kryesore.....	15
5	Qasja në informata.....	17
5.1	Qasja në informata rreth rasteve.....	17
5.2	Gjetja e sallave në gjykata.....	19
5.3	Dobia e Informacionit të Ofruar nga Gjykata.....	21
5.4	përdorimi i web faqes se gjykatës për çasje në informacion.....	23
5.5	rangimi i përgjithshëm për qasjen në informata.....	25
6	Efikasiteti dhe Paanshmëria.....	26
6.1	Efikasiteti i gjykatës.....	26
6.2	Trajtimi në gjykatë.....	28
6.3	Përdorimi i gjuhës amtare.....	29
6.4	Trajtimi i barabartë në gjykatë.....	30
6.5	Rangimi i përgjithshëm i efikasitetit dhe paanësisë.....	31
7	Perceptimi i korrupsionit.....	33
7.1	Shkaqet e korrupsionit.....	33
7.2	Ryshfeti.....	39
7.3	Renditja e përgjithshme e mbizotërimit të ryshfetit.....	41
8	Rekomandime për përmirësim.....	42
9	Shtojca I.....	46
10	SHTOJCA 2.....	48

I HYRJE

Ky hulumtim është dizajnuar dhe ndërmarrë nga Demokraci Plus për të mbledhur pikëpamjet e qytetarëve për performancën e shtatë Gjykatave Themelore të Kosovës. I bërë për nevoja të Programit të USAID-it për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë (ISSP), hulumtimi ka për qëllim që t'u ofroj informata gjykatave për përmirësim të efikasitetit dhe reputacionit të tyre para qytetarëve. Rezultatet e hulumtimit mund të shërbejnë si një mjet për matjen e cilësisë së shërbimeve në të shtatë Gjykatat Themelore. Ky hulumtim i shërben Gjykatave Themelore, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, dhe të gjitha organeve tjera brenda sistemit gjyqësor në Kosovë. Qëllimi kryesor është identifikimi i zbrazëtirave në tri fusha dhe përmirësimi i efikasitetit dhe informimit më të mirë të shfrytëzuesëve të shërbimeve në gjykata.

Programi për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë i USAID është një aktivitet katër vjeçar i sundimit të ligjit në Kosovë si vazhdimësi e përpjekjeve të mëhershme të USAID për të avancuar sundimin e ligjit në Kosovë dhe të siguroj që sistemi i drejtësisë operon në mënyrë profesionale, efikase dhe llogaridhënëse. Programi fokusohet në promovimin e sistemit të drejtësisë bazuar në standardet më të larta të pavarësisë, paanësisë, integritetit, llogaridhënies, transparencës dhe në mbështetje të funksionimit dhe integritetit të strukturave gjyqësore në komunat në veri.

Fuqizimi i efikasitetit dhe efektshmërisë në administrimin e gjyqësorit dhe ofrimit të shërbimeve cilësore

Përmes USAID, Programi për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë ndihmon Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe gjykatat në konsolidimin e rezultateve në efektshmerinë dhe menaxhimin e tyre. Kjo arrihet duke lehtësuar decentralizimin e kompetencave administrative dhe institucionalizimin e sistemeve dhe mjeteve për menaxhim efikas të gjykatave dhe rasteve. Aktivitetet nën këtë objektivë zvogëlojnë numrin e rasteve të pazgjidhura dhe pengesat procedurale në efikasitet dhe efektshmëri të gjykatave.

Rritja e përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit në sistem gjyqësor

Programi punon ngushtë me KGJK-në, gjykatësit dhe stafin e gjykatës në ndërtimin e kapaciteteve për të ofruar drejtësi profesionale dhe efikase. Gjithashtu promovon vazhdimin e edukimit dhe integritetin e iniciativave publike si bazë për një gjyqësor i cili është i qasshëm, i besueshëm dhe efektiv.

Mbështetja e funksionimit dhe integritetit të strukturave gjyqësore në veri

Programi për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë mbështet KGJK-në dhe gjykatat në aktivizimin e strukturave gjyqësore në veri të Kosovës bazuar në Marrëveshjen e Sektorit të Drejtësisë të nënshkruar në mes të qeverisë së Kosovës dhe Serbisë më 2015. Kjo marrëveshje ofron integritetin e institucioneve, operimin e gjykatës dhe burime juridike në veri. Ky program i USAID mbështet gjykatat individuale në këtë regjion me inventarë të rasteve dhe transfere, zvogëlim të rasteve të pazgjidhura, menaxhim të rasteve dhe ndërtim të kapaciteteve për gjykatës dhe staf të gjykatave.

Demokraci Plus është një organizatë e pavarur jo qeveritare e themeluar nga një grup i aktivistëve të cilët besojnë në fuqizimin e mëtejshëm të vlerave demokratike në Kosovë. Objektiv i kryesor i D+ është të promovojë vlerat dhe praktikat demokratike të cilat do ta fuqizojnë edhe më shumë zërin e shoqërisë kosovare. D+ ka për qëllim të kontribuoj në krijimin e praktikave të mira të qeverisjes, fuqizimin e sundimit të ligjit, mbështetjen e partive politike dhe proceseve për zgjedhje të lira dhe të paanshme. D+ implementon projekte të ndryshme me qëllim që t'i sjell vendimmarrësit më afër qytetarëve përmes hulumtimit të politikave, lehtësimin e dialogut, ndërveprimit dhe edukimin publik.

2 METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

2.1 VARIABLAT E STUDIUARA

2.1.1 Qasja në Informata Publike

Qasja në informata publike – për qëllim të këtij studimi matet nga: (1) përvoja e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatave rreth lehtësisë së marrjes së informatave për rastet e tyre nga gjykatat ku rastet e tyre janë nën gjykim, (2) përvoja e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatave mbi dobinë e informacioneve të ofruara nga gjykata; (3) përvoja e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatave me gjetjen/lokacionin e zyrës së nevojshme apo sallës në gjykatë; (4) përdorimi i web faqes së gjykatës për të marrë informacionet e nevojshme; (5) përvoja e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës, me dobinë e web faqes së gjykatës në gjetjen e informacionit të kërkuar.

2.1.2 Efikasiteti

Efikasiteti i gjykatave themelore matet nga perspektiva e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës. Është e rëndësishme të theksohet se një gjykatë mund të jetë efikase apo jo në operimin e saj sipas praktikave dhe standardeve të përcaktuara të një institucioni të drejtësisë, megjithatë, ky studim ka për qëllim që të thellohet në perceptimin e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës mbi atë se sa efikase ata mendojnë se është gjykata bazuar në përvojat personale kur kanë kërkuar shërbim nga kjo e fundit. Vlerësimi është bërë bazuar në perceptimin e arsyeshmerisë së kohëzgjatjes së marrjes së një shërbimi nga gjykata në ditën kur respondentit ishte anketuar, dhe kohëzgjatjen për zgjidhjen e rasteve të tyre. Për më tepër, ky seksion matë perceptimet e trajtimit të drejtë dhe të barabartë, përmes vlerësimit të cilësisë së trajtimit të marrë nga stafi i gjykatës, veçanërisht nëse respondentët ishin trajtuar me mirësjellje dhe respekt, mundësinë e përdorimit të gjuhës së tyre amëtare dhe perceptimin e tyre nëse rasti i tyre ishte gjykuar drejt.

2.1.3 Korrupsioni

Dimensioni i korrupsionit ishte po ashtu një matje e perceptimit të shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatave, përmes rangimit në shkallën e parë, dytë, tretë, katërt dhe pestë të korrupsionit në gjyqësorë për pesë opsionet e ofruara (ndikimi politik, ndikimi i palëve në proces, motivimi financiar i gjykatësve, gjykata jo-efektive për shkak të burimeve të kufizuara dhe ndikimi i përfaqësuesve ligjor). Shpërfaqja e mitos dhe nëse shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës u është kërkuar personalisht mito apo diçka e ngjashme dhe për çfarë arsye, është një dimension tjetër që është përdorur për të hulumtuar shkallën e korrupsionit në Gjykatat Themelore. Në fund, kjo variabël është hulumtuar edhe më tutje përmes pyetjes mbi pozitën e punëtorëve të gjykatës të cilët kërkuan mito apo që në të vërtetë ishin korruptuar.

2.2 ANKETA

Për ta përgatitur këtë raport, Demokraci Plus ka zhvilluar anketë (exit survey) me 817 njerëz – kërkues të shërbimeve nga shtatë Gjykatat Themelore. Ky hulumtim është ndërmarrë me qëllim të vlerësimit të përvojave të shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatave dhe perceptimin e tyre rreth qasjes në informata publike, nivelit të efikasitetit dhe shpërfaqjes së korrupsionit në sistemin gjyqësor në Kosovë, veçanërisht në shtatë Gjykatat Themelore. D+ ka zgjedhur një qasje hulumtuese e cila involvon një kombinim të metodave hulumtuese cilësore dhe sasore, gjetjet e të cilave ndihmojnë rreth zhvillimit dhe reformave.

Lëndët e pazgjidhura janë një prej sfidave kryesore me të cilat po ballafaqohet sistemi gjyqësor në Kosovë. Në nëntor të vitit 2017, Gjykatat Themelore në Kosovë kishin një total prej 198,199 lëndëve të pazgjidhura. Shpërndarja e këtij numri në gjykatat e ndryshme themelore varion dhe nuk është në proporcion me numrin e popullatës rezidente në këto regjione.

Përmes këtij studimi ne ishim të interesuar në gjetjen nëse Gjykatat me numër më të madh të lëndëve ishin më pak efektive, kishin më pak qasje në informata dhe një prevalencë më të lartë të korrupsionit, krahasuar me ato me numër më të vogël të lëndëve të pazgjidhura, të cilat për arsye statistikore, ishin përdorur si *popullsia*. Për shkak të çështjeve të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së informatave private, hulumtimi në këtë mënyrë nuk ka një kornizë të mostrimit për popullatën në fjalë, e që do të ishte një listë e plotë e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës nga e cila pjesëmarrësit në hulumtim do të përzgjidheshin rastësisht. Në mungesë të kësaj, lëndët e pazgjidhura të gjykatave janë përdorur si një kornizë mostër.

Tabela 1. Lëndët e pazgjidhura për secilën Gjykatë Themelore

Gjykata Themelore	Lëndët në gjykata/Popullsia (N)
Prishtinë	101,301
Ferizaj	33,830
Gjilan	9,916
Prizren	17,372
Gjakovë	14,445
Pejë	9,590
Mitrovicë	11,745
Totali	198,199

Në këto rrethana, D+ organizoi një sondazh, nga ku vëzhgimet ishin seleksionuar duke u bazuar në një teknikë të mostrave sistematike, me çdo të pestin person i cili ka dalur nga ndërtesa e gjykatës. Anketuesit kanë qëndruar në dalje të objektit të gjykatës dhe kanë intervistuar respondentët të cilët u pajtuan të përgjigjen në pyetësorë, deri sa mostra arriti numrin e parapërcaktuar të respondentëve. Duke pasur parasysh që qasja është probabilistike, të gjeturat mund të përdoren për të bërë interferime statistikore rreth tërë popullatës së shfrytëzuesve të shërbimeve të këtyre gjykatave. Madhësia e mostrës përbëhet nga 817 respondentë.

Lëndët e pazgjidhura të secilës prej shtatë Gjykatave Themelore janë të shpërndara në mënyrë jo të barabartë dhe me ndryshime relativisht të mëdha në numër të lëndëve – Gjykata Themelore e Prishtinës (duke përfshirë 4 degët e saj) ka 142,892 lëndë të pazgjidhura, Gjykata Themelore e Gjilanit (duke përfshirë 3 degët e saj) ka 18,789 lëndë të pazgjidhura. Kështu, gjykatat me numër më të madh të lëndëve do të kishin një numër jo proporcional më të madh të objektivimeve në studim, duke rrezikuar vlefshmërinë e të gjeturave në gjykatat tjera. Për shembull, gjykata e Prishtinës do të kishte 307 objektivime, derisa gjykata e Gjilanit do të kishte vetëm 40. Për ta tejkaluar këtë problem, është

kalkuluar një minimum i madhësisë së mostrës për secilën gjykatë dhe është vendosur niveli i konfidencës prej 90% me marzhinë të gabimit prej +/- 10%.

Tabela 2. Llogaritja e madhësisë së mostrës për secilën gjykatë

Gjykata Themelore	Lëndët në gjykata/Popullsia (N)	Ndarja e mostrës /Probabiliteti i seleksionimit	Madhësia aktuale e mostrës për secilën gjykatë
PRISHTINË	101,301	0.511	358
FERIZAJ	33,830	0.171	119
GJILAN	9,916	0.050	68
PRIZREN	17,372	0.088	68
GJAKOVË	14,445	0.073	68
PEJË	9,590	0.048	68
MITROVICË	11,745	0.059	68
TOTALI	198,199		817

Të dhënat janë mbledhur dhe analizuar nga popullata e përgjithshme e shfrytëzuesve të shërbimeve të Gjykatës Themelore: të pandehurit dhe paditësit e të gjitha llojeve të rasteve, gjithashtu avokatët dhe/apo përfaqësuesit ligjor të palëve. Mostrimi nuk ka marrë parasysh ndarje siç janë gjinia, mosha apo arsyeja që pjesëmarrësi ka qenë në objektin e gjykatës. Megjithatë, disa rezultate nga perspektiva e avokatëve/përfaqësuesve në procedurë ka ndryshuar mjaft shumë, nga llojet tjera të shfrytëzuesve të shërbimeve të cilët nuk kishin kualifikime profesionale në fushën e drejtësisë. Në veçanti, përgjigjet e bllokut të pyetjeve të lidhura me qasjen në informata ka ndryshuar shumë varësisht nëse pjesëmarrësi në hulumtim ishte avokatë apo palë në procedurë. Megjithatë, objektivi primar i hulumtimit ishte që të merren informacione mbi performancën e gjykatave themelore dhe rezultatet e dala të të dy nënmostrave. Metodologjia e përdorur në rangimin e Gjykatave në të tri dimensionet – qasje në informata, efikasitet dhe korrupsion ishin kalkuluar duke përdorur vlerat mesatare për secilën pyetje në hulumtim dhe duke kalkuluar mesataret e secilit seksion të secilës variabël të studiuar.

2.2.1 Të dhënat demografike

Informacioni i prezantuar në tabelën më poshtë tregon të dhënat demografike për pjesëmarrësit në studim. Duke pasur parasysh se mostrimi ishte probabilistik, secili person i cili ka dalur nga gjykata në ditën kur anketuesit ishin aty, kishin mundësi që të përzgjidheshin si respondent (nëse e ka plotësuar kushtin e të qenurit paditës apo i paditur, apo avokat/përfaqësues i autorizuar). Shumica e

pjesëmarrësve ishin meshkuj (82%), duke reflektuar gjininë e personave të akuzuar në Gjykatat Themelore, nga të cilat 95.4% janë meshkuj dhe 4.6% femra¹.

Tabela 3. Pjesëmarrësit në hulumtim sipas gjinisë

	Meshkuj	Femra
	82.42%	17.58%

Tabela 4. Pjesëmarrësit në hulumtim sipas gjinisë, sipas regjionit

	Meshkuj	Femra
Prishtinë	89.04%	10.96%
Mitrovicë	76.47%	23.53%
Prizren	82.35%	17.65%
Pejë	76.14%	23.86%
Ferizaj	89.92%	10.08%
Gjakovë	75.71%	24.29%
Gjilan	57.53%	42.47%

Shumica e respondentëve i takojnë grup moshës 25 – 44 vjeçare. Shumica e pjesëmarrësve, në fakt gati 84%, ishin palë në një proces gjyqësor, derisa 16% ishin avokat apo përfaqësues të autorizuar. Për më tepër, mbi gjysma e respondentëve ishin në gjykatë në ditën e hulumtimit si palë në raste penale (27%) apo për raste të kundërvajtjes (26%), pasuar nga rastet civile, administrative, komerciale dhe me të mitur.

Tabela 5. Grup moshë e respondentëve

Mosha 18 – 24	Mosha 25 – 34	Mosha 35 – 44	Mosha 45 – 54	Mosha 55 – 64	Mosha 65+
8.67%	23.04%	29.81%	21.26%	12.59%	4.63%

¹ Agjencioni i Statistikave të Kosovës. Krimi dhe Drejtësia Penale, Statistikat e Jurisprudencës 2016. P. 9. Më tepër në: <http://ask.rks-gov.net/media/3564/statistikat-e-jurisprudencës-për-persona-madhor-2016.pdf>

Tabela 6. Grup mosha e respondentëve, sipas rajonit

	Mosha 18 – 24	Mosha 25 – 34	Mosha 35 – 44	Mosha 45 – 54	Mosha 55 – 64	Mosha 65+
Prishtinë	5.90%	22.19%	33.99%	23.31%	8.99%	5.62%
Mitrovicë	4.41%	27.94%	39.71%	16.18%	5.88%	5.88%
Prizren	1.47%	25.00%	27.94%	17.65%	22.06%	5.88%
Pejë	15.91%	26.14%	31.82%	17.05%	9.09%	0%
Ferizaj	16.81%	23.53%	23.53%	15.13%	15.97%	5.04%
Gjakovë	5.71%	14.29%	21.43%	27.14%	24.29%	7.14%
Gjilan	13.7%	24.66%	17.81%	28.77%	15.07%	0%

2.2.2 Arsyja pse respondentët kanë ardhur në gjykatë

Shumica e respondentëve (83.73%) ishin palë në procese gjyqësore. Në Prizren, gati të gjithë respondentët (98.53%) ishin palë në procese gjyqësore.

Tabela 7. Arsyja pse respondentët ishin në gjykatë në ditën kur u realizua hulumtimi

Palë në proces	Avokat apo përfaqësues i autorizuar
83.73%	16.27%

Tabela 8. Arsyja pse respondentët ishin në gjykatë në ditën kur u realizua hulumtimi

	Palë në proces	Avokat apo përfaqësues i autorizuar
Prishtinë	88.48%	11.52%
Mitrovicë	72.06%	27.94%
Prizren	98.53%	1.47%
Pejë	73.86%	26.14%

	Palë në proces	Avokat apo përfaqësues i autorizuar
Ferizaj	84.03%	15.97%
Gjakovë	78.57%	21.43%
Gjilan	73.97%	26.03%

Tabelat më poshtë tregojnë numrin dhe përqindjen e njerëzve të cilët deklaruan llojin e rastit për të cilin kishin ardhur në gjykatë ditën në të cilën ishte realizuar hulumtimi. Është e qartë që grupi më i madh i njerëzve kishin lëndë në procedurën penale, të pasuar nga kundërvajtjet, derisa rastet e procedurave me të miturit ishin në numrin më të vogël. Një pjesë e madhe e respondentëve të Gjykatës Themelore në Mitrovicë (63.27%) deklaruan se ishin në gjykatë për çështje civile.

Tabela 9. Lloji i rastit që i solli palët në gjykatë në ditën kur u realizua hulumtimi

Penale	Kundërvajtje	Civile	Komerciale	Administrative	Të mitur
27.09%	26.10%	23.4%	11.63%	10.78%	0.99%

Tabela 10. Lloji i rastit që i solli palët në gjykatë në ditën kur u realizua hulumtimi, sipas regjionit

	Penale	Civile	Komerciale	Administrative	Administrative	Të mitur
Prishtinë	21.9%	20.95%	11.75%	17.14%	27.3%	0.95%
Mitrovicë	10.2%	63.27%	0%	0%	26.53%	0%
Prizren	26.87%	25.37%	31.34%	0%	16.42%	0%
Pejë	21.54%	21.54%	0%	9.23%	41.54%	6.15%
Ferizaj	26.00	19%	18.00%	13%	24.00%	0%
Gjakovë	27.27%	32.73%	10.91%	3.64%	25.45%	0%
Gjilan	81.48%	0%	0%	1.85%	16.67%	0%

2.3 DISKUTIMET NË FOKUS GRUPE

Demokraci Plus realizoi Diskutime në Fokus Grupe (DFG) me përdorues të shërbimeve të shtatë Gjykatave Themelore: Prishtinë, Prizren, Gjilan, Mitrovicë, Gjakovë, Ferizaj dhe Pejë. Pjesëmarrësit në këto DFG ishin qytetarë të cilët kanë qenë palë në procese gjyqësore si paditës apo të pandehur në 12 muajt e fundit, dhe avokat të cilët i kanë rastet në Gjykatat Themelore respektive. Ky aktivitet ka pasuar anketimin “exit poll” me 817 respondent të të njëjtit target grup i cili ishte realizuar në nëntor të 2017. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte të hulumtohen aspekte të të tri shtyllave të hulumtuara – Qasja në informata, Efikasiteti dhe Korrupsioni, dhe të verifikohen të gjeturat e sondazhit.

Tabela 11. Orari i Fokus Grupeve dhe Demografia e Pjesëmarrësve

Vendi	Data	Numri i pjesëmarrësve	Demografia
PRISHTINË	20 Dhjetor, 2017	11	F: 5 M: 6
PRIZREN	28 Dhjetor, 2017	10	F: 5 M: 5
GJILAN	12 Janar, 2018	10	F: 3 M: 7
MITROVICË	19 Janar, 2018	6	F: 2 M: 4
GJAKOVË	25 Janar, 2018	7	F: 3 M: 4
FERIZAJ	25 Janar, 2018	6	F: 1 M: 5
PEJË	29 Janar, 2018	6	F: 4 M: 2

Pjesëmarrësit ishin rekrutuar në mesin e popullatës të cilët kishin qenë palë në procedura gjyqësore si paditës apo të pandehur në 12 muajt e fundit², dhe gjykatës të cilët ushtrojnë detyrën në Gjykatat Themelore respektive, dhe u ishin dhënë nga 10 Euro për shpenzimet e pjesëmarrjes së tyre. Diskutimet zgjatën afërsisht dy orë secili. Udhëheqja e diskutimeve ishte realizuar nga hulumtuesi i lartë i Demokraci Plus në bashkëpunim me përfaqësuesit e JSSP. Pjesëmarrësve iu kërkua ta prezantojnë veten me emër dhe llojin e rastit që kanë pasur në gjykatë më së voni, dhe moderatori siguroi anonimitet dhe përdorim të të dhënave të mbledhura vetëm për qëllim të këtij hulumtimi. Duke ndjekur prezantimin e moderatorit për qëllimin e studimit, diskutimi filloi me pyetje të hapura për opinionin e përgjithshëm të pjesëmarrësve rreth përvojave të tyre me shërbimet në gjykata. Diskutimi u udhëhoq nga tri fushat tematike të hulumtuara, domethënë: qasja në informata, efikasiteti dhe korrupsioni, dhe pyetjet derivuan nga pyetjet dhe rezultatet e sondazhit. Pjesëmarrësve iu kërkua që të diskutojnë të gjeturat e hulumtimit derisa moderatori vazhdoj me pyetje të detajizuara për të hulumtuar çështjet e diskutimit më thellësisht.

² Kushti i të qenit pjesë në një proces në 12 muajt e fundit ishte përbushur nëse: (1) rasti i tyre u hap në 12 muajt e fundit, (2) rasti i tyre u hap në çfarëdo kohe pas vitit 2000, por vazhdon të jetë i hapur edhe sot, apo (3) rasti i tyre ishte zgjidhur në çfarëdo kohe në 12 muajt e fundit, pa marrë parasysh se kur ishte hapur.

3 CILËSIA E SHËRBIMEVE NË GJYKATA

Si i rangojnë shfrytëzuesit e gjykatave Gjykatat Themelore në Kosovë?

Rangimi sipas prevalencës së korrupsionit *	Rangimi
Gjakovë	1
Pejë	1
Ferizaj	3
Prishtinë	4
Gjilan	5
Mitrovicë	6
Prizren	7

*Rangimi i Gjykatave Themelore bazuar në përgjigjet e respondentëve, ku 1 është krahasimisht më mirë se sa gjykatat tjera të ranguar dhe 7 është krahasimisht më e dobët se sa gjykatat tjera të ranguar. Gjykatat Themelore në Pejë dhe Gjakovë nuk raportuan ndonjë joshje për mito.

Rangimi sipas Efikasitetit dhe Paanësisë*	Rangimi
Ferizaj	1
Pejë	2
Gjilan	3
Prizren	4
Prishtinë	5
Gjakovë	6
Mitrovicë	7

*Rangimi i Gjykatave Themelore bazuar në përgjigjet e respondentëve, ku 1 është krahasimisht më mirë se sa gjykatat tjera të ranguar dhe 7 është krahasimisht më e dobët se sa gjykatat tjera të ranguar.

Rangimi i Gjykatave Themelore sipas Qasjes në Informata	Rangimi
Ferizaj	1
Gjilan	2
Pejë	3
Gjakovë	4
Prizren	5
Mitrovicë	6
Prishtinë	7

* Rangimi i Gjykatave Themelore bazuar në përgjigjet e respondentëve, ku 1 është krahasimisht më mirë se sa gjykatat tjera të ranguar dhe 7 është krahasimisht më e dobët se sa gjykatat tjera të ranguar.

Sistemi i drejtësisë është një nga shtyllat më vitale të çdo demokracie. Dega e gjyqësorit është baza e sundimit të ligjit dhe simbol i drejtësisë dhe paanësisë në të cilën një shoqëri demokratike bazohet për

barazi para ligjit. Në një nivel substancial, për qytetarët e Kosovës, ky institucion perceptohet të jetë i padenjë për t'i besuar dhe mbështetur në të. Studime të shumta nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare për matjen e perceptimit publik mbi gjyqësorin, kanë treguar se qytetarët kanë besim të ulët ndaj këtij sektori dhe perceptcion për nivel të lartë të korrupsionit. Të gjeturat nga Transparency International mbi shkallën e përhapjes së korrupsionit në gjyqësor, tregon një rezultat prej 4.1 nga 5, ku 5 tregon nivelin më të lartë të perceptimit të korrupsionit.³ Për më tepër, Puls i Publik i UNDP për 2017 tregon se vetëm 36.9% e respondentëve janë të kënaqur me punën e gjykatave dhe vetëm 33.1% janë të kënaqur me punën e Zyrës së Prokurorit.⁴ I njëjti hulumtim zbulon se në fund të 2017, 24.9% u përgjigjen pozitivisht kur u pyetën rreth perceptimit mbi ekzistencën e shkallës së lartë të korrupsionit në gjykata në Kosovë.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se shfrytëzuesit e shërbimeve të gjykatave kanë shprehur shkallë më të lartë të kënaqshmërisë me shërbimet e gjykatave krahasuar me publikun e gjërë jo-shfrytëzues të shërbimeve të gjykatave. Derisa Puls i Publik i programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) tregon se vetëm 37% e publikut beson në sistemin gjyqësor, ndërsa përqindja në mesin e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatave është në mënyrë të konsiderueshme më e lartë apo treguar në përqindje, 57%.

Rezultati më shqetësues i këtij hulumtimi të ndërmarrë është se shumica e respondentëve – palët në proces dhe avokatët /përfaqësuesit e autorizuar të palëve, pra shfrytëzuesit e shërbimeve të të shtatë Gjykatave Themelore, e konsiderojnë ndikimin politik të jetë shkaku më i rëndësishëm i korrupsionit në gjyqësor.

	Ndikimi Politik	Ndikimi i palëve në proces	Motivimi financiar i gjykatësve	Gjykatë joefikase me burime të kufizuara	Ndikimi i avokatit
Pala në procedurë	40.95%	15.43%	14.84%	13.80%	14.99%
Avokati apo përfaqësuesi i autorizuar	48.78%	17.89%	10.57%	13.82%	8.94%

Njësoj shqetësues është fakti se mbi 58% e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatave kanë përshtypje se ata nuk trajtohen barabartë nga punëtorët e gjykatës, që do të thotë se nga përvoja e tyre ata besojnë se njerëz të ndryshëm marrin trajtim favorizues nga gjykatësit dhe punëtorët tjerë të gjykatës.

³ "Integriteti Gjyqësor në Kosovë – Raport Vlerësimi". Zyra e Kombeve të Bashkuara mbi Drogat dhe Krimin dhe UNDP Prishtinë. 2014

⁴ "Puls i Publik XII". USAID dhe UNDP Kosovë. Nëntor 2016.

http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/SAEK/UNDP%20UNODC%20Report%20on%20Judicial%20Integrity_Eng.pdf

Perceptimi i shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës mbi trajtimin e barabartë në gjykatë

Po	Jo	Disi
41.45%	23.87%	34.68%

Kanali më i kapshëm përmes të cilit një shfrytëzues i shërbimeve të gjykatës në kohën e teknogjisë informative kërkon informacione, është përmes web faqes zyrtare institucionale. Gjykatat Themelore të Kosovës kanë web faqe funksionale, megjithatë si një burim i informacionit ato nuk përdoren nga 83% e respondentëve të anketuar. Si matje e qasjes së informacionit, kjo e gjetur ishte hulumtuar edhe më tutje në fokus grupe, ku është konkluduar se, në përgjithësi, njerëzit nuk janë të vetëdijshëm për ekzistencën/disponueshmërinë e tyre. Edhe ata të cilët janë të vetëdijshëm, nuk janë të kënaqur me përmbajtjen (nga 17.34% të cilët kanë thënë se kanë kërkuar informacion në web faqet e gjykatës, vetëm një e katërta pohojnë se kanë gjetur çdo gjë të cilën ishin duke e kërkuar).

Qasja në informata

Po	Jo
17.34%	82.66%

4 TË GJETURAT KRYESORE

Ky hulumtim mbi Transparencën/Qasjen & Efikasitetin e Gjykatave Themelore në Kosovë është mbështetur nga Programi për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë /USAID dhe përgatitur nga Demokraci Plus me 817 respondentë në shtatë Gjykata Themelore. Hulumtimi gjeti një numër të mangësive në cilësinë e shërbimeve të ofruara nga gjykatat. Raporti gjithashtu ofron një mori rekomandimesh për ta përmirësuar transparencën dhe cilësinë e shërbimeve të gjykatave.

Disa nga të gjeturat e hulumtimit janë:

- Një e katërta e pjesëmarrësve deklaruan se ata nuk trajtohen barabartë me të tjerët;
- Qytetarët janë të frustruar me pamundësinë për tu qasur në informata rreth rasteve të tyre dhe në përgjithësi me mungesën e njohurisë rreth asaj se çka gjykatat bëjnë në aktivitetet e tyre ditore;
- Informatat e ofruara nga gjykatat lidhur me punën e tyre, në përgjithësi janë të pa dobishme;
- Korrupsioni në sistemin gjyqësor ka evoluar dhe është bërë më i sofistikuar, duke u zhvilluar me këmbim të favoreve më shumë se sa ofrim të parave;
- Nga popullata prej 817 respondentëve, 38 apo 4.51% raportuan se u është kërkuar mito nga gjykatës apo punëtor tjerë të gjykatës;
- Si perceptim i përgjithshëm, ndikimi politik është një nga shkaqet kryesore të korrupsionit

Hulumtimi zbulon se gjykata të ndryshme themelore ofrojnë shkallë të ndryshme të cilësisë së shërbimeve për qytetarë. Gjykata Themelore e Ferizajt është top performuesi në këtë aspekt, duke

udhëhequr në të dy kategoritë e Qasjes në Informata dhe atë të Efikasitetit dhe Paanësisë. Kjo gjykatë gjithashtu rankohet mirë në kategorinë e tretë të matur këtu me një frekuencë të ulët të mitos së raportuar në krahasim me gjykatat tjera.

Gjykata me performancën më të ulët, sipas respondentëve të hulumtimit ishte Gjykata Themelore në Mitrovicë. Kjo gjykatë ishte rankuar më së ulëti apo e dyta më e ulëta në të tri kategoritë. Ndërsa, Gjykata Themelore e Prishtinës dhe Prizrenit performojn pak më mirë se Mitrovica në lidhje me performancën krahasuese. Respondentët në Gjykatën Themelore në Prizren raportohet t'u është kërkuar mito më shumë se dyfishi i të gjitha gjykatave tjera së bashku.

Tabela 12. Rankimi i Gjykatave Themelore në të tri variablat e hulumtuara

Gjykata Themelore	Rankimi i përgjithshëm me pikë mesatare*	Qasja në informata**	Efikasiteti dhe Paanësia**	Prevalenca e mitos**
Ferizaj	1.66	1	1	3
Pejë	2	3	2	1
Gjilan	3.33	2	3	5
Gjakovë	3.66	4	6	1
Prishtinë	5.33	7	5	4
Prizren	5.33	5	4	7
Mitrovicë	6.33	6	7	6

* Rezultati prej 1 tregon pozicionimin më të mirë në krahasim me 6 gjykatat tjera themelore, si një mesatare e rezultatit të tri variablave të hulumtuara: qasja në informata, efikasiteti dhe paanshmëria dhe prevalenca e mitos; rezultati prej 7 përkatësisht, do të thotë pozicionimi më i dobët në krahasim me 6 gjykatat tjera themelore.

** Rezultati prej 1 do të thotë pozicionimi më i mirë në krahasim me 6 gjykatat tjera themelore në qasje në informata, efikasitet dhe paanshmëri dhe prevalenca e mitos, respektivisht e kalkuluar duke përdorur mesataret e grupit të pyetjeve korresponduese të secilës variabël të hulumtuar.

Qytetarët si shfrytëzues të shërbimeve të gjykatave në fokus grupe ishin të frustruar me pamundësinë për tu qasur në informata rreth rasteve të tyre dhe në përgjithësi me mungesën e njohurisë rreth asaj se çka gjykatat bëjnë në aktivitetet e tyre ditore. Shumica dërrmuese e pjesëmarrësve thanë se e vetmja mënyrë për të marrë informacione rreth rastit të tyre ishte që të shkojnë fizikisht në ndërtesën e gjykatës dhe mënyrat e komunikimit siç janë telefoni apo emailat janë kanal i pamundshëm për të arritur ndokënd në gjykatë (stafin administrativ apo gjykatësit). Një besim mbizotërues ishte se numri i gjykatësve është i vogël dhe se kjo është arsyeja kryesore për joefikasitet në gjykatë, me disa komente të bëra rreth mungesës së profesionalizmit dhe të ekspertizës së stafit. Sa i përket korrupsionit, kishte shumë pak pjesëmarrës të cilët e kishin përjetuar personalisht. Megjithatë, disa e pranuan se do ta konsideronin korrupsionin për ta përsheptuar zgjidhjen e rastit të tyre.

Në anën tjetër, në kontakt me shumicën e fokus grupit, juristët morën një pozitë defanzive sa i përket qasjes në informata duke pretenduar se qytetarët priren që ta bezdisin administratën e gjykatës me pyetje dhe kërkesa jo të duhura dhe kjo qëndron posaqërisht në rastet kur ata nuk angazhojnë avokat, e cila sipas tyre ndodhë shpesh. Tema gjithëpërfshirëse mbi dimensionin e korrupsionit ishte se korrupsioni është bërë më i "sofistikuar" në atë se mitot monetare tradicionale/tipike janë zëvendësuar me favore. Në fund, avokatët në përgjithësi treguan empati për gjykatësit dhe i justifikuan

vonesat në zgjidhjen e rasteve dhe lëndët e pazgjidhura, me faktin se thjeshtë se nuk ka gjykatës të mjaftueshëm për ta trajtuar fluksin e rasteve.

5 QASJA NË INFORMATA

Ky seksion vë në pah nëse qytetarët të cilët shfrytëzojnë shërbimet e gjykatës janë në gjendje të marrin informata të mjaftueshme rreth rastit të tyre në një mënyrë e cila është e përshtatshme dhe e lehtë për ata për ta kuptuar, qoftë për gjetjen e një salle në gjyq apo zyrë që atyre iu nevojitet brenda objektit të gjykatës, dhe përdorimi i web faqes së gjykatës për të kërkuar informacion e gjithashtu edhe për të gjetur informacionin që ata kërkojnë.

5.1 QASJA NË INFORMATA RRETH RASTEVE

Qasja në informata rreth rastit të hapur në gjykatë është një e drejtë themelore të cilën secili qytetar duhet ta gëzojë. Në gjykatat themelore në Kosovë, megjithatë, kanalet e komunikimit në mes të palëve në procedura dhe administratës së gjykatës nuk janë të qarta dhe shumica dërmuese e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës të cilët nuk janë profesionistë të fushës së drejtësisë, e kanë të vështirë të marrin informata rreth rastit të tyre derisa ai është duke u gjykuar. Jo çuditërisht, një dallim i qartë në mes të avokatëve/përfaqësuesëve të autorizuar të palëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës reflekton në rezultatet e hulumtimit sa i përket qasjes në informata rreth rasteve.

Mbi tri të katërtat e avokatëve/përfaqësuesëve të autorizuar e kanë më të lehtë të gjejnë informata mbi rastet, krahasuar me mbi gjysmën e palëve në gjykim. Mbi 55% e palëve në gjykime, të cilët në supozojmë që nuk kanë ndonjë eksperiencë profesionale juridike apo edukim formal në drejtësi, e kanë të vështirë apo jashtëzakonisht të vështirë të gjejnë informacion rreth rastit të tyre. Në anën tjetër, avokatët apo përfaqësuesit e autorizuar kryesisht pretendojnë se gjetja e informacionit rreth rasteve është jashtëzakonisht e lehtë (58%) apo disi e lehtë (20%), me mbetjen prej 22% të respondentëve të shpërndarë mbi opsionin neutral apo disi dhe jashtëzakonisht lehtë. Për ta hulumtuar këtë çështje më në thellësi, pyetja është diskutuar në fokus grupe, ku pjesëmarrësve u është kërkuar të diskutojnë kanalet përmes të cilave ata marrin informacione nga gjykata.

Shumica dërmuese e pjesëmarrësve në fokus grup në përgjithësi theksuan se marrja e informacionit duke përdorur mjetet moderne të komunikimit siç janë telefoni apo emaili është praktikisht e pamundur sepse (1) në shumicën e rasteve është e pamundur për të gjetur një adresë elektronike të një punëtori të gjykatës, (2) ata nuk përgjigjen edhe nëse iu dërgohet një email, (3) ata nuk përgjigjen në telefon, (4) nëse përgjigjen në telefon, ata nuk e ofrojnë informacionin e kërkuar. Kështu, i vetmi kanal i komunikimit, një drejtimësh, është gjykata e cila dërgon shkresa zyrtare tek palët përmes postës së rregulltë.

Tabela 13. Përqindja e njerëzve të cilët raportuan mbi lehtësinë e marrjes së informatave mbi rastin, ndaras për palët në procedurë dhe avokatët apo përfaqësuesit e autorizuar.

Nga përvoja juaj, sa e lehtë është të gjeni informacion rreth rastit tuaj?

	Jashtëzakonisht vështirë	Disi vështirë	As vështirë as lehtë	Disi lehtë	Jashtëzakonisht lehtë
Palë në procedurë	17.87%	12.62%	14.33%	27.66%	27.52%
Avokat apo përfaqësues i autorizuar	8.03%	7.3%	7.3%	19.71%	57.66%

Gjykata Themelore e Prishtinës në veçanti duket të jetë problematike në këtë aspekt, me gati gjysmën e respondentëve që u përgjigjen se e kanë të vështirë apo jashtëzakonisht të vështirë të gjejnë informacion për rastet e tyre. Specifikisht, pjesëmarrësit në DFG theksuan se përveç numrit të rastit, është e pamundur për palët ta dinë cili është statusi i rastit dhe cili është gjykatësi i caktuar për ta gjykuar rastin. Në anën tjetër, një pjesëmarrës i këtij DFG e ndau përvojën e vet rreth komunikimit me gjykatën përmes zyrës së informimit me email dhe telefon, e që vetëm pas këmbënguljes së madhe, ajo e bëri të mundur marrjen e informacionit të nevojshëm pa shkuar në gjykatë.

Gjykata e Mitrovicës vijon me qerëkun apo 25% të respondentëve që janë përgjigjur se është e vështirë apo jashtëzakonisht e vështirë për të marrë informacion të tillë. Megjithatë, pjesëmarrësit e DFG e theksuan faktin se qasja në informacion është e kufizuar nëse pala nuk është e përfaqësuar nga një avokat. Avokatët pjesëmarrës në DFG gjithashtu shprehën pakënaqësinë e tyre me gjykatën, duke theksuar faktin se informacioni duhet të sigurohet personalisht, pasi që personeli i gjykatës nuk përgjigjet në thirrjet telefonike apo email. Ata gjithashtu theksuan se pak apo aspak informacion iu ipet para dëgjimit të parë.

Në krahasim, mbi 90% të respondentëve në Ferizaj e kanë të lehtë të marrin informacion rreth rasteve të tyre. Pjesëmarrësit e fokus grupit në përgjithësi e pranojnë se telefoni apo email nuk janë kanalet përmes të cilave ata mund të marrin informacione. Ata shkojnë në gjykatë fizikisht për të marrë informata dhe në përgjithësi kjo është një praktikë e pranuar.

Ngjashëm, përdoruesit e Gjykatës Themelore në Pejë, në një shkallë të madhe deklarojnë se është disi apo jashtëzakonisht lehtë për të marrë informacion rreth rastit të tyre. Gjatë diskutimit, pjesëmarrësit e fokus grupit deklaruan se është më e lehtë t'i qasesh informatave nëse e njeh dikën i cili punon në gjykatë, dhe është gati e pamundur nëse kundërshtari juaj është një person me ndikim. Mënyra më e mirë për të marrë informatat e nevojshme është shkuarja në gjykatë personalisht, pasi që informacioni i postuar në web faqe rrallë herë ndihmon dhe adresat elektronike të zyrtarëve nuk mund të gjenden në web faqe.

Gjykata Themelore në Gjakovë qëndron relativisht mirë me gati 70% të shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës që e vlerësojnë procesin e marrjes së informatave rreth rasteve të tyre si disi apo

jashtëzakonisht të lehtë. E gjetura ishte vërtetuar nga pjesëmarrësit e fokus grupit, ku edhe avokatët edhe palët i konfirmuan këto të gjetura, duke thënë se gjykatësit dhe të gjithë punëtorët tjerë të gjykatës janë ndihmues kur u bëhen pyetje nga shfrytëzuesit e shërbimeve të gjykatës. Palët thanë se për të marrë informata ata shkojnë në gjykatë personalisht, të cilën nuk e kanë bezdi, pasi që janë tashmë të mësuar me këtë gjë. Avokatët në anën tjetër deklaruan se informacioni mund të merret edhe përmes telefonit.

Shfrytëzuesit e shërbimeve të Gjykatës Themelore të Prizrenit, reflektuan një opinion relativisht pozitiv sa i përket mundësisë për qasje në informata, me shumicën e respondentëve të cilët deklaruan se ishte e lehtë t'u qasesh informatave në lidhje me rastin e tyre. Juristët thanë se të gjitha informatat që iu nevojiten palëve janë në ftesën e dërguar nga Gjykata. Në anën tjetër, qytetarët ndjenë se kanë nevojë për më shumë informacion se sa përmban ftesa, dhe për këtë arsye ata lihen shpesh në konfuzion.

Ngjashëm, Gjilani qëndron relativisht mirë në të gjeturat e hulumtimit, megjithatë pjesëmarrësit e DFG thanë se e vetmja mënyrë për të marrë informata nga Gjykata është nëse ata shkojnë personalisht deri në gjykatë, duke lënë të kuptohet se punëtorët e gjykatës nuk përgjigjen në thirrjet telefonike apo emaila.

Tabela 14. Përqindja e respondentëve të cilët raportuan mbi lehtësinë e marrjes së informacionit mbi rastin, ndaras për secilën Gjykatë Themelore.

Në përvojën tuaj, sa e lehtë është të gjeni informacion rreth rastit tuaj?

	Jashtëzakonisht vështirë	Disi vështirë	As vështirë as lehtë	Disi lehtë	Jashtëzakonisht lehtë
Prishtinë	33.99%	14.04%	12.64%	19.94%	19.38%
Mitrovicë	8.82%	16.18%	14.71%	29.41%	30.88%
Prizren	2.94%	8.82%	17.65%	47.06%	23.53%
Pejë	2.27%	13.64%	12.50%	29.55%	42.05%
Ferizaj	0.84%	4.20%	4.20%	17.65%	73.11%
Gjakovë	2.86%	5.71%	22.86%	41.43%	27.14%
Gjilan	4.11%	15.07%	16.44%	31.51%	32.88%

5.2 GJETJA E SALLAVE NË GJYKATA

Ngjashëm me përgjigjet lidhur me qasjen në informata rreth rasteve, tabela vijuese tregon përqindjen e njerëzve të cilët raportuan mbi lehtësinë e gjetjes së sallave që iu janë nevojitur, ndaras për palët në proces dhe avokatët apo përfaqësuesit e autorizuar. Natyrisht, avokatët apo përfaqësuesit e autorizuar e kanë pak më të lehtë për t'i gjetur sallat në krahasim me palët dhe kjo lehtësi i atribuohet faktit se

ata janë shfrytëzues të rregullt të shërbimeve në gjykata. Gjetja e sallës në gjykatë apo zyrës nuk është ndonjë problem i madh tek pjesa e qytetarëve të rregullt gjithashtu.

Tabela 15. Lehtësia e gjetjes së sallës apo zyrës së nevojshme brenda objekteve të gjykatës

A ishte e lehtë të gjendet salla apo zyra e nevojshme në gjykatë?

	Jashtëzakonisht vështirë	Disi vështirë	As vështirë as lehtë	Disi lehtë	Jashtëzakonisht lehtë
Palët në procedurë	4.11%	6.38%	6.67%	21.42%	61.42%
Avokati apo përfaqësuesi i autorizuar	2.92%	0.73%	0.73%	6.57%	89.05%

Një vështrim më i afërt tek secila Gjykatë Themelore tregon se në përgjithësi, pjesëmarrësit e hulumtimit nuk kishin përjetuar ndonjë vështirësi të veçantë në ndonjë gjykatë, me përjashtim të Gjykatës Themelore të Gjakovës ku 8.57% deklaruan se e kanë pasur jashtëzakonisht të vështirë t'i gjejnë sallat apo zyrat në gjykatë dhe Gjykata e Prishtinës ku gati 12% e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës thanë se e kishin të vështirë apo jashtëzakonisht të vështirë për ta gjetur sallën apo zyrën e kërkuar. Pjesëmarrësit në DFG ishin përgjithësisht të kënaqur me shenjat orientuese në ndërtesa, megjithatë pjesëmarrësit nga dy regjione ndanë shqetësimet rreth lokacionit të vetë gjykatave. Pjesëmarrësit në Pejë theksuan faktin se ndërtesa e gjykatës themelore është në një zonë problematike, pasi që ajo zë një pronë qendrore në komunitet – pjesën kryesore të qendrës së qytetit, e cila ka një shkallë të lartë të frekuentimit dhe tërheq vëmendje. Pjesëmarrësit deklaruan se Peja është një qytet i vogël me lidhje të ngushta kulturore dhe komunitare dhe duke u parë të hysh në ndërtesën e gjykatës mund të jetë stigmatizuese për individin. Sipas tyre, lokacioni i ndërtesës duhet të jetë në një zonë më të largët për të shmangur pyetjet dhe/apo shpifjet potenciale që mund t'i bëhen personit i cili hyn dhe del nga objekti i gjykatës. Në anën tjetër, ndërtesat e gjykatës në Prishtinë janë të vendosura larg nga qendra, në një zonë e cila nuk është lehtë e qasshme me transporti publik (orari i autobusit nuk është i shpeshtë, taksi është relativisht i shtrenjtë). Pjesëmarrësit e DFG theksuan faktin se kjo është një papërshtatshmëri e madhe.

Tabela 16. Lehtësia e gjetjes së sallave apo zyrave të nevojshme brenda objekteve të gjykatave, përgjigjet e pjesëmarrësve për secilën Gjykatë Themelore

A ishte e lehtë të gjendet salla apo zyra e nevojshme në gjykatë?

	Jashtëzakonisht vështirë	Disi vështirë	As vështirë as lehtë	Disi lehtë	Jashtëzakonisht lehtë
Prishtinë	5.9%	6.18%	2.25%	12.92%	72.75%

	Jashtëzakonisht vështirë	Disi vështirë	As vështirë as lehtë	Disi lehtë	Jashtëzakonisht lehtë
Mitrovicë	4.41%	7.35%	5.88%	20.59%	61.76%
Prizren	0%	7.35%	16.18%	42.65%	33.82%
Pejë	0%	3.41%	11.36%	29.55%	55.68%
Ferizaj	0.84%	0%	5.04%	8.40%	85.71%
Gjakovë	8.57%	1.43%	0%	10.00%	80.00%
Gjilan	2.74%	13.7%	12.33%	38.36%	32.88%

5.3 DOBIA E INFORMACIONIT TË OFRUAR NGA GJYKATA

Tabela 17. Dobia e informacionit të ofruar nga gjykata

Sa i dobihëm ishte informacioni i ofruar nga gjykata?

Tejet të padobishme	Deri diku të padobishme	As të dobishme e as të padobishme	Deri diku të dobishme	Tejet të dobishme
12.47%	7.84%	17.1%	32.3%	30.29%

Shumica e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës (63%) deklaruan se informacioni i ofruar nga gjykata rreth rastit të tyre, ishte ose ndihmues ose jashtëzakonisht ndihmues. Një pjesë shqetësuese prej 20%, megjithatë thanë se informacioni ishte *tejet i padobishëm* apo *deri diku i padobishëm*. Kur të dhënat ndahen në kategori të palëve për një procedurë dhe personi i autorizuar apo avokati, figurat në secilën kategori ndryshojnë, por ndjekin të njëjtin trend me shumicën e përgjigjeve që i takojnë *deri diku* apo *tejet të dobishme*. Siç është pritur, shumë nga grupi i fundit mendon se informacioni është i dobishëm dhe kjo është e qartë për shkak të faktit se ata janë më shumë në kontakt me Gjykatën në punën e tyre ditore dhe kështu e kuptojnë informacionin më mirë dhe mund të mos u nevojiten aq shumë sqarime sa palëve në procedurë.

Tabela 18. Dobia e informacionit të ofruar nga gjykata, përgjigjet sipas llojit të shfrytëzuesit të shërbimeve të gjykatës

Sa i dobihëm ishte informacioni i ofruar nga gjykata?					
	Tejet të padobishme	Deri diku të padobishme	As të dobishme e as të padobishme	Deri diku të dobishme	Tejet të dobishme
Palët në procedurë	14.04%	8.65%	18.72%	33.19%	25.39%
Avokati apo përfaqësuesi i autorizuar	4.38%	3.65%	8.76%	27.74%	55.47%

Përveç respondentëve të Gjykatës Themelore në Prishtinë, mbi një e katërta e të cilëve deklaruan se informacioni i ofruar nga gjykata ishte *tejet i pa dobishëm*, në përgjithësi pjesëmarrësit ishin të kënaqur me informacionin e ofruar nga gjykatat. Shumica e pjesëmarrësve vlerësuan se informacioni ishte *deri diku* apo *tejet i dobishëm*, derisa një pakicë i përshkruan ato si *deri diku të padobishme*. Performuesit më të mirë në këtë dimension janë gjykatat e Gjakovës, Gjilanit dhe Pejës të cilat kishin nën 5% të respondentëve në anën negative të spektrit.

Tabela 19. Dobia e informacionit të ofruar nga gjykata, përgjigjet sipas Gjykatave Themelore

Sa i dobihëm ishte informacioni i ofruar tek ju nga gjykata?					
	Tejet të padobishme	Deri diku të padobishme	As të dobishme e as të padobishme	Deri diku të dobishme	Tejet të dobishme
Prishtinë	26.97%	14.33%	12.64%	22.19%	23.88%
Mitrovicë	2.94%	8.82%	14.71%	47.06%	26.47%
Prizren	2.94%	2.94%	25.00%	58.82%	10.29%
Pejë	0%	4.55%	13.64%	35.23%	46.59%
Ferizaj	3.36%	0.84%	14.29%	19.33%	62.18%
Gjakovë	0%	0%	42.86%	48.57%	8.57%
Gjilan	1.37%	2.74%	17.81%	45.21%	32.88%

5.4 PËRDORIMI I WEB FAQES SE GJYKATËS PËR ÇASJE NË INFORMACION

Shtatë Gjykatat Themelore në Kosovë kanë web faqe funksionale me informacion që përfshin informata të përgjithshme mbi orarin e punës, shërbimet e ofruara dhe informatat kontaktuese, e deri tek informacioni specifik mbi orarin dhe vendimet të gjykimeve. Mirëpo, rezultatet e hulumtimit tregojnë se ato nuk përdoren si burim informacioni nga shfrytëzuesit e shërbimeve të gjykatës. Shumica e pjesëmarrësve të hulumtimit (82.66%) deklaruan se nuk e përdorin web faqen e gjykatës për të kërkuar informacion. Nga 17.34% të cilët e përdorin atë, vetëm një e katërta pohuan se e kanë gjetur çdo gjë të cilën e kanë kërkuar.

Tabela 20. Përdorimi i web faqes së gjykatës

A e përdorni web faqen e gjykatës?		
Po	Jo	
17.34%	82.66%	
		Po
		Jo
		Prishtinë
		9.55%
		90.45%
		Mitrovicë
		25.00%
		75.00%
		Prizren
		19.12%
		80.88%
		Pejë
		29.55%
		70.45%
		Ferizaj
		12.61%
		87.39%
		Gjakovë
		18.57%
		81.43%
		Gjilan
		38.36%
		61.64%

Një analizim më i detajuar i Gjykatave Themelore tregon se pjesëmarrësit nga Gjilani e përdorin web faqen më së shumti (38.36%) krahasuar me gjykatat tjera, pasuar nga Peja (29.55%). Çuditërisht, Gjykata Themelore në Prishtinë qëndron në fund të listës, ndonëse Prishtina është qyteti më i madh dhe kryeqyteti i vendit, dhe qendra kryesore akademike dhe e zhvillimeve sociale, që rrjedhimisht e ka përdorimin dhe depërtimin më të madh të internetit, dhe kjo pritej që të reflektohej në përdorimin e web faqeve zyrtare për të marrë informata.

Nuk kam gjetur asnjë informacion të nevojshëm	Gjeta shumë pak informacion të nevojshëm	Gjeta shumicën e informacionit të nevojshëm	Gjeta të gjithë informacionin e nevojshëm
16.44%	19.18%	39.73%	24.66%

Atyre që u deklaruan se përdorin web faqen e gjykatës u është kërkuar që ta vlerësojnë shkallën në të cilën ata e kanë gjetur informacionin e kërkuar. Duke pasur parasysh numrin e vogël të përgjigjeve pozitive në këtë pyetje, numri i përgjigjeve në pyetjen pasuese është i vogël (e shoqëruar me një normë të lartë të mos-përgjigjes) dhe kështu të gjeturat nga Gjykatat Themelore janë paraqitur me numra në vend të përqindjeve.

Gjykata Themelore në Gjiilan pozicionohet më mirë në këtë dimension me të gjithë respondentët të cilët deklarojnë se kanë gjetur shumicën apo të gjithë informacionin që atyre u është nevojitur, e pasuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë ku shumica e respondentëve pohuan të kenë gjetur shumicën apo të gjithë informacionin që atyre iu është nevojitur në web faqen e gjykatës. Pjesëmarrësit e DFG në përgjithësi konfirmuan të gjeturat e hulumtimit, duke theksuar se mënyra më e mirë për ta gjetur informacionin e kërkuar është që të shkohet në gjykatë personalisht. Ata të cilët e kanë vizituar web faqen, thanë se informacioni i postuar aty rrallë herë është i dobishëm, dhe as informacioni bazik siç janë adresat elektronike nuk mund të gjenden në web faqe. Pjesëmarrësit e DFG në Prizren duke përfshirë juristët por edhe ata që nuk ishin juristët u pajtuan me gjetjen se shumica e shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës e përdorin web faqen zyrtare të saj. Ata gjithashtu deklaruan se faqja e Facebook-ut e kësaj gjykate azhurnohet rregullisht.

Tabela 21. Përgjigjet e pjesëmarrësve të cilët përdorin web faqen e Gjykatës mbi atë se a kanë gjetur atë që kanë qenë duke e kërkuar në web faqe të Gjykatave Themelore

A i keni gjetur informatat që keni kërkuar?				
	Nuk kam gjetur asnjë informacion të nevojshëm	Gjeta shumë pak informacion të nevojshëm	Gjeta shumicën e informacionit të nevojshëm	Gjeta të gjithë informacionin e nevojshëm
Prishtinë	13 persona	12 persona	6 persona	3 persona
Mitrovicë	2 persona	4 persona	11 persona	0 persona
Prizren	1 persona	2 persona	7 persona	3 persona
Pejë	4 persona	6 persona	10 persona	6 persona
Ferizaj	3 persona	3 persona	5 persona	4 persona
Gjakovë	1 persona	1 persona	8 persona	3 persona
Gjiilan	0 persona	0 persona	11 persona	17 persona

5.5 RANGIMI I PËRGJITHSHËM PËR QASJEN NË INFORMATA

Rangimi mbi dimensionin e qasjes në informata është rezultat i mesatares së përgjigjeve në pesë pyetjet vijuese nga të gjithë pjesëmarrësit në secilën Gjykatë Themelore:

1. Në përvojën tuaj, sa e lehtë ishte të gjeni informata rreth rastit tuaj?
2. A ishte e lehtë të gjeni sallat apo zyrat që iu janë nevojitur?
3. Sa të dobishme ishin informatat e dhëna nga gjykata?
4. A e keni përdorur web faqen e gjykatës?
5. A e keni gjetur atë që e keni kërkuar?

Gjykata Themelore	Rangimi
Ferizaj	1
Gjilan	2
Pejë	3
Gjakovë	4
Prizren	5
Mitrovicë	6
Prishtinë	7

**Rangimi i Gjykatave Themelore bazuar në përgjigjet e respondentëve, ku 1 është krahasimisht më mirë se sa gjykatat e ranguarat dhe 7 është më dobët se sa gjykatat tjera të ranguarat.*

Gjykata Themelore e Ferizaj e ka rangimin më të mirë në këtë aspekt. Kjo për shkak se qytetarët mund të gjenin informata relativisht lehtë, nuk kishin ndonjë vështirësi në gjetjen e sallave, dhe gjykata iu ofron informacione të dobishme. Në anën tjetër të spektrit, gati gjysma e respondentëve në Gjykatën Themelore në Prishtinë e kishin të vështirë të gjenin informacion rreth rasteve të tyre, dhe një e katërta u përgjigj që informacioni i ofruar nga gjykata ishte jashtëzakonisht i pa dobishëm.

6 EFIKASITETI DHE PAANSHMËRIA

Ky seksion i hulumtimit trajton përvojën e respondenteve në marrjen e shërbimeve nga gjykata. Respondentët u pyetën nëse arritën të kryejnë punë në gjykatë brenda një kohe të arsyeshme në ditën që u anketuan, sa kohë po i merr gjykatës për ta zgjidhur rastin e tyre dhe a ishin trajtuar barabartë me të tjerët.

6.1 EFIKASITETI I GJYKATËS

Të mbingarkuara me raste, gjykatat në Kosovë kanë kohë të kufizuar për tu marrë me klientët e tyre. Tabela më poshtë tregon, me kategori të përqindjeve, se si pjesëmarrësit përshkruajnë aftësinë e tyre për të përfunduar punë për të cilën kanë ardhur në gjykatë brenda një kohe të arsyeshme.

Tabela 22. Aftësia për të përfunduar punë në gjykatë në një kohë të arsyeshme

A ishit në gjendje që të përfundoni punë në gjykatë brenda një kohe të arsyeshme?

	Nuk pajtohem fuqishëm	Nuk pajtohem	As pajtohem as nuk pajtohem	Pajtohem	Pajtohem fuqishëm
Prishtinë	25.28%	16.85%	10.96%	22.75%	24.16%
Mitrovicë	10.29%	48.53%	8.82%	19.12%	13.24%
Prizren	0%	2.94%	32.35%	57.35%	7.35%
Pejë	0%	13.64%	36.36%	30.68%	19.32%
Ferizaj	2.52%	12.61%	12.61%	22.69%	49.58%
Gjakovë	2.86%	21.43%	15.71%	41.43%	18.57%
Gjilan	1.37%	5.48%	38.36%	38.36%	16.44%

Kur respondentët ishin pyetur “Sa kohë është duke i marr gjykatës për ta zgjidhur rastin tuaj?” përgjigjet variojnë shumë nga njëra gjykatë tek tjetra. Mbi 40% e respondentëve të anketuar në Prishtinë deklaruan se gjykatës i merr më gjatë se 2 vite për t’i zgjidhur rastet e tyre; Pjesëmarrësit e DFG konfirmuan të njëjtat të dhëna. Sipas avokatëve që ishin pjesë e diskutimit, një pjesë e madhe vonohen për shkak të Gjykatës së Apelit e cila i kthen dhe rikthen rastet për shkak të gabimeve procedurale, ndonëse, sipas tyre këto raste mund të zgjidhen lehtë nga Gjykata e Apelit pa u kthyer mbrapsht në gjykatë për rigjykim.

Respondentët nga Prizreni (64.7%) deklaruan një përvojë pozitive në këtë aspekt, të gjeturat u konfirmuan nga pjesëmarrësit e DFG, të cilët vazhduan me vlerësimin se gjykata themelore është më efikase në rastet civile se sa në ato penale. Pjesëmarrësit u pajtuan se gjykata është mjaft efikase, duke pasur parasysh numrin e rasteve të cilat i pranon. Prandaj, ata u pajtuan me të gjeturat e hulumtimit që 58% e respondentëve menduan se rastet e tyre u zgjidhën në kohë të arsyeshme. Megjithatë, një nga problemet kryesore me këtë gjykatë është vonesa – dhe shpesh anulimet e dëgjimeve pa ndonjë

arsye valide nga gjykatësi. Megjithatë, ky është një problem i përgjithshëm në të gjitha gjykatat themelore.

Shumica dërrmuese e respondentëve të Gjilanit u shprehën se ishin në gjendje t'i përfundojnë punët e tyre në gjykatë në një kohë të arsyeshme, për më tepër, afro 40% thanë se rastet e tyre zgjidhen në më pak se gjashtë muaj. Megjithatë, pjesëmarrësit e DFG prezantuan një situatë shumë më të keqe se sa ajo e pasqyruar në të gjeturat e hulumtimit. Ata ishin veçanërisht të pakënaqur me efikasitetin e Gjykatës dhe shumica ndanë përvojat se kanë qenë të “zvarritur” nga gjykata me vite për rastet e tyre dhe disa ishin akoma në proces. Avokatët i dalluan departamentet e Gjykatës, duke thënë se Departamenti Penal është më efikas se sa ai Civil. Megjithatë, në të dy departamentet, sipas pjesëmarrësve, numri i gjykatësve është në mënyrë alarmante i vogël krahasuar me numrin e rasteve.

Shumica e respondentëve nga Mitrovica (58.82%) deklaruan se nuk e kanë të mundur t'i kryejnë punët në gjykatë brenda një afati të arsyeshëm kohor, megjithatë, 40% e respondentëve thanë se gjykata merr më pak se gjashtë muaj për ta zgjidhur një rast. Pjesëmarrësit e DFG i justifikuan këto të gjetura duke thënë se rastet siç janë divorcet, apo rastet e punës mund të zgjidhen edhe brenda gjashtë muajve. Ndërsa, edhe avokatë edhe pjesëmarrësit tjerë nuk e ndjejnë se ishin në gjendje t'i zgjidhin rastet e tyre në një kohë të arsyeshme. Një nga pjesëmarrësit ka një rast për pronë të cili ka marrë mbi shtatë vite për tu zgjidhur, ndërsa i një tjetri mori katër vite për tu zgjidhur. Diçka tjetër që avokatët kanë vërejtur është se përqindja e rasteve të kthyer nga Gjykata e Apelit është në shkallë alarmuese. Kjo është raportuar për shkak se gjykatësit janë më tepër të shqetësuar për ta arritur kuotën e tyre mandatore – numrin e rasteve që ata duhet të zgjidhin në muaj – se sa të marrin vendimin e duhur me ligj. Numëri i pazgjidhur i rasteve në Gjykatën e Mitrovicës i atribuohet numrit të vogël të gjykatësve dhe pjesëmarrësit pajtohen se kjo shtrton rrugë për korrupsion.

Respondentët në Gjakovë në përgjithësi ishin të kënaqur me periudhën kohore që iu ka marrë për t'i zgjidhur rastet e tyre, dhe kjo u vërtetua në DFG, ku është vërejtur se disa raste mund të marrin më shumë kohë, por në përgjithësi ka pasur progres në vitet e fundit në këtë aspekt. Vonesat në zgjidhjen e rasteve i janë atribuar Gjykatës së Apelit, pasi që shumë raste transferohen në një instance më të lartë.

Mbi 50% e pjesëmarrësve të hulumtimit në Ferizaj u pajtuan fuqishëm ose u pajtuan se ishin në gjendje t'i përfundonin punët në gjykatë brenda një afati të arsyeshëm kohor. Në fakt 70% thanë t'i kenë zgjidhur rastet e tyre për një vit apo edhe më pak. Sfidat më të mëdha është që gjykata merr vendime të drejta, por ato nuk ekzekutohen. Shumica e shembujve në këtë drejtim erdhën nga pjesëmarrësit të cilët kishin qenë pjesë e rastit të Fabrikës së Tubave. Sa i përket kohës për zgjidhjen e rasteve, pjesëmarrësit u pajtuan me të gjeturat e hulumtimit dhe deklaruan më tutje se varet nga rastet dhe nëse pala ka një avokat (kur palët angazhojnë një avokat për t'i përfaqësuar në gjykatë, rasti zakonisht zgjidhet më shpejt se sa kur pala nuk ka angazhuar shërbim të avokatit, pasi që ata janë të familjarizuar me procedurat). Ankesa në këtë drejtim kishte për prokurorët të cilët konsideroheshin të jenë politikisht të motivuar dhe për këtë nuk ngrisin raste për njerëzit që kanë lidhje politike apo janë në gjendje financiare që t'i korruptojnë akterët relevant në sistem.

Më tepër se gjysma e respondentëve nga Peja, thanë se atyre u merr më tepër se një vit për t'i zgjidhur rastet e tyre, me 32% që thonë se u merr mbi dy vite. Në DFG, avokatët ua atribuuan këto të gjetura llojit të rastit që palët kanë. Rastet penale zakonisht marrin një vit për t'u zgjidhur, pasi që ka më tepër gjykatës në atë departament dhe gjykatësit punojnë në mënyrë më efektive në rastet e asaj natyre. Megjithatë, rastet civile, të cilat duhet të jenë një prioritet gjithashtu, marrin më tepër se dy vite për tu zgjidhur, pasi që numri i gjykatësve në atë departament është më i vogël krahasuar me numrin e rasteve që kanë. Rastet e pazgjidhura janë gjithashtu rezultat i procedurave të panevojshme

burokratike dhe për t'i bërë gjërat edhe më keq janë punëtorët e gjykatave, duke përfshirë gjithashtu disa gjykatës, të cilëve u mungon profesionalizmi në aspektet e përmendura përgjatë DFG-ve: dukja profesionale, komunikimi/mënyra e ndërveprimit me palët, dhe shkrimi i dobët ligjor në vendimet dhe verdiktet e lëshuara. Për këtë, pjesëmarrësit mendojnë se duhet të ketë një institucion mbikëqyrës, me politika më të forta, i cili duhet t'i mban gjykatësit përgjegjës në një standard më të lartë.

Tabela 23. Koha e nevojshme për zgjidhjen e rastit nga Gjykata Themelore

Sa kohë i merr gjykatës për ta zgjidhur rastin tuaj?

	Më pak se 6 muaj	Deri në një vit	Deri në dy vite	Më shumë se dy vite
Prishtinë	23.88%	20.22%	14.04%	41.85%
Mitrovicë	44.12%	11.76%	25.00%	19.12%
Prizren	29.41%	33.82%	11.76%	25.00%
Pejë	18.18%	23.86%	25.00%	32.95%
Ferizaj	25.21%	25.21%	21.85%	27.73%
Gjakovë	41.43%	30.00%	17.14%	11.43%
Gjilan	38.36%	35.62%	21.92%	4.11%

6.2 TRAJTMI NË GJYKATË

Ndonëse gjykata nuk pritet që të jetë një ambient miqësor për klientët, megjithatë qytetarët presin një nivel mirësjelljeje dhe respekti kur të ballafaqohen me zyrtarët e gjykatës. Gjykata Themelore në Pejë udhëheq në këtë aspekt, ku gati 98% e respondentëve ishin të kënaqur/jashtëzakonisht të kënaqur me trajtimin nga stafi i gjykatës. Prishtina është në fund të këtij rangi me gati 17% të respondentëve që raportojnë të jenë jashtëzakonisht/disi të pakënaqur.

Tabela më poshtë tregon numrin dhe përqindjen e pjesëmarrësve të cilët raportuan kënaqësinë e tyre me mënyrën e trajtimit në gjykatë ditën kur është realizuar sondazhi. Një shumicë përkrahet ndërvëprimin e tyre me zyrtarët e gjykatës si shumë apo disi të kënaqshëm, dhe pak respoendentë u shprehën si *disi të pakënaqur*.

Tabela 24. Cilësia e trajtimit nga stafi i gjykatës

A jeni trajtuar me mirësjellje dhe respekt?

	Jashtëzakonisht i pakënaqur	Disi i pakënaqur	Asnjëra	Disi i kënaqur	Jashtëzakonisht i kënaqur
Prishtinë	11.24%	5.62%	4.49%	22.47%	56.18%
Mitrovicë	5.88%	1.47%	1.47%	29.41%	61.76%

	Jashtëzakonisht i pakënaqur	Disi i pakënaqur	Asnjëra	Disi i kënaqur	Jashtëzakonisht i kënaqur
Prizren	0%	5.88%	17.65%	70.59%	5.88%
Pejë	1.14%	0%	1.14%	37.5%	60.23%
Ferizaj	0%	2.52%	9.24%	28.57%	59.66%
Gjakovë	4.29%	4.29%	4.29%	62.86%	24.29%
Gjilan	2.74%	5.48%	6.85%	61.64%	23.29%

6.3 PËRDORIMI I GJUHËS AMTARE

Mundësia për ta përdorur gjuhën amtare është një e drejtë elementare e garantuar me Kushtetutë⁵ dhe e specifikuar me Ligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve⁶, dhe është një tregues tjetër për nivelin e kënaqshmërisë së një klienti me gjykatat. Në përgjithësi, mesatarisht 97.5% e respondentëve u përgjigjen se ata ishin në gjendje të komunikojnë në gjuhën e tyre në gjykatë. Megjithatë, duke pasur parasysh se sondazhi është bërë në degët kryesore të Gjykatave themelore, të gjeturat mund të mos reflektojnë situatën aktuale. Gjykata themelore në Prishtinë, për shembull ka një degë në komunën e Graçanicës ku shërbehet popullata me shumicë serbe. Për më tepër, Gjakova ka popullatë me shumicë shqiptare, që do të thotë se sondazhi mund të mos ketë përfshirë ndonjë pjesëmarrës nga minoritetet tjera etnike, prandaj të gjithë respondentët u përgjigjen se ata kanë mundur ta përdorin gjuhën e tyre amtare. Ndërsa sa i përket gjetjeve në Gjykatën Themelore të Mitrovicës, në kohën kur është realizuar sondazhi, kjo gjykatë ka qenë me lokacion në Vushtrri dhe si rrjedhojë ekziston mundësia që të anketuarit të mos kenë qenë pjesëtar të komuniteteve tjera joshqiptarë, prandaj rezultati mund të mos reflektoj situatën e tanishme me zhvendosjen e degës në Mitrovicë.

Derisa, gjykata themelore e Ferizaj rezulton më mirë se gjykatat tjera në indikatorët tjerë, numri më i madh i respondentëve (5.88%) të cilët u përgjigjen se nuk kanë mundur ta përdorin gjuhën e tyre amtare janë përdorues të kësaj gjyqate. Kjo mund të jetë për shkak të faktit se në këtë komunë ka edhe komunitete jo-shumicë. Tabela më poshtë tregon numrin dhe përqindjen e responentëve të cilët deklaruan nëse ishin në gjendje që ta përdorin gjuhën e tyre amtare deri sa kryenin punë në gjykatë. Shumica dërrmuese e pjesëmarrësve deklaruan se ishin në gjendje që të flisnin në gjuhën e tyre.

Tabela 25. Mundësia për të folur në gjuhën amtare

A ishit në gjendje që të flisni në gjuhën amtare?

	Po	Jo
Prishtinë	97.19%	2.81%

⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kapitulli I, Neni. 5

⁶ Ligji mbi Përdorimin e Gjuhëve (Ligji Nr. 02/L-37)

	Po	Jo
Mitrovicë	100%	0%
Prizren	97.06%	2.94%
Pejë	98.86%	1.14%
Ferizaj	94.12%	5.88%
Gjakovë	100%	0%
Gjilan	95.89%	4.11%

6.4 TRAJTIMI I BARABARTË NË GJYKATË

Spektori i drejtësisë është i obliguar që të shërbejë të gjithë në mënyrë të barabartë. Megjithatë, vetëm 41.5% e respondentëve mendojnë se gjykatat i trajtojnë të gjithë qytetarët barabartë. Gati një e katërta (23.9%) u përgjigjen se ata nuk ishin trajtuar barabartë, që përbën shkak për shqetësim pasi dëmton besimin në paanshmërinë e gjykatave. Tabela më poshtë tregon numrin dhe përqindjen e pjesëmarrësve të cilët mendojnë se ishin trajtuar si çdonjëri në gjykatë.

Tabela 26. Shkalla në të cilën shfrytëzuesit e shërbimeve të gjykatës mendojnë se u trajtuan në mënyrë të barabartë

A u trajtuat ngjashëm si të tjerët?

	Po	Jo	Deri diku
Përqindja	41.45%	23.87%	34.68%

Një vështrim më i thellë në secilën gjykatë themelore tregon se përgjigjet janë disi të ndara në mes të pozitive, negative, apo neutrale, ku Mitrovica rangohet më së keqi dhe Gjilani më së miri.

Tabela 27. Shkalla në të cilën shfrytëzuesit e shërbimeve mendojnë se u trajtuan barabartë nga Gjykata Themelore

A u trajtuat ngjashëm si të tjerët?

	Po	Jo	Disi
Prishtinë	35.39%	35.67%	28.93%
Mitrovicë	54.41%	13.24%	32.35%
Prizren	33.82%	23.53%	42.65%

	Po	Jo	Disi
Pejë	44.32%	13.64%	42.05%
Ferizaj	42.86%	19.33%	37.82%
Gjakovë	41.43%	12.86%	45.71%
Gjilan	60.27%	6.85%	32.88%

DFG vërtetojnë të gjeturat e sondazhit. Pjesëmarrësit në Gjakovë theksuan se vendimet e gjykatës nuk janë gjithmonë të paanshme dhe pjesëmarrësit i'a atribuojnë këtë kulturës në Gjakovë, ku emri i familjes (emër "i respektueshëm" i familjes sipas standardeve të kulturës lokale) është shumë i rëndësishëm dhe ndonjëherë gjykatësit fokusohen më shumë në atë se sa në prova. Në Ferizaj perceptimi për paanësinë është mjaft pozitiv, gjithashtu edhe pjesëmarrësi e DFG unanimisht e pranuan se gjykata i trajton rastet pa anime, por sfida më e madhe është se edhe pse rastet gjykohen paanshëm, vendimet nuk ekzekutohen, shumica e shembujve në këtë aspekt vijnë nga pjesëmarrës të cilët bëjnë pjesë në rastin e Fabrikës së Tubave (një rast i rëndësishëm në këtë gjykatë themelore).

6.5 RANGIMI I PËRGJITHSHËM I EFIKASITETIT DHE PAANËSISË

Rangimi mbi dimensionin e efikasitetit dhe paanësisë është një rezultat i mesatares së përgjigjeve në pesë pyetjet vijuese nga të gjithë pjesëmarrësit në secilën gjykatë themelore:

1. A ishit në gjendje që të mbaroni punë në gjykatë brenda një kohe të arsyeshme?
2. Sa kohë po i merr gjykatës që ta zgjidhë rastin tuaj?
3. A u trajtuat me mirësjellje dhe respekt?
4. A u trajtuat njëjtë si të tjerët?

Gjykata Themelore	Rangimi
Ferizaj	1
Pejë	2
Gjilan	3
Prizren	4
Prishtinë	5
Gjakovë	6
Mitrovicë	7

*Rangimi i Gjykatave Themelore bazuar në përgjigjet e respondentëve, ku 1 është krahasimisht më mirë se gjykatat tjera të ranguar dhe 7 është krahasimisht më dobët se sa gjykatat tjera të ranguar.

Gjykata themelore në Ferizaj rangohet në krye të listës sa i përket efikasitetit. Shfrytëzuesit e shërbimeve të kësaj gjykate themelore kanë mundur që ta kryejnë punën në gjykatë relativisht më shpejt se sa në gjykatat tjera themelore në Kosovë. Ky institucion gjithashtu rangohet më lartë në mesin e respondentëve sa i përket ndjenjës së të trajtimit të barabartë dhe me mirësjellje nga stafi i gjykatës. Në DFG, pjesëmarrësit pajtohen se cilësia e shërbimeve është përmirësuar në mënyrë

domethënëse në vitet e fundit me vendosjen e gjykatës në ndërtesën e re dhe rritjen e numrit të gjykatësve dhe kjo qëndron edhe në rastet kur vendimi nuk ishte marrë në favor të tyre (apo në favor të klientëve të tyre). Gjykata themelore në Pejë, u rangua e dyta në bllokun pyetjeve të paanësisë dhe efikasitetit dhe udhëheq pasi që është gjykata ku respondentët mendojnë se u trajtuan me më së shumti mirësjellje dhe respekt.

Në anën tjetër të spektrit, Gjykata themelore e Mitrovicës në krahasim me gjykatat tjera themelore u rangua më së ulëti. Respondentët gjithashtu e ranguan më së ulëti kur u pyetën nëse kishin arritën të kryenin punë brenda një kohe të arsyeshme.

7 PERCEPTIMI I KORRUPSIONIT

Ekziston një perceptim i gjerë në publik se gjyqësori në Kosovë është i prekur nga korrupsioni në shkallë të lartë. Kjo mbështetet nga studime të ndryshme nga organizatat lokale dhe ndërkombëtare dhe është përmendur në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovë për 2017 dhe 2018. Konkretisht, sipas këtyre raporteve: Gjyqësori është [...] i cenueshëm nga ndikimi i tepërt politik dhe institucionet e sundimit të ligjit kanë nevojë për mbështetje për t'i ndërtuar kapacitetet e tyre.⁷

Në këtë situatë, ky hulumtim ka për qëllim të përcakton prevalencën e korrupsionit në Gjykata Themelore të Kosovës bazuar në perceptimin dhe eksperiencën e shfrytëzuesve të shërbimeve të tyre. Pjesëmarrësve të hulumtimit iu është kërkuar të rangojnë shkaqet më të rëndësishme të korrupsionit në mesin e pesë opsioneve të ofruara në pyetësor, si mënyra kryesore në të cilat mitot apo favorët këmbehen për të ndikuar trajtimin dhe/apo rezultatet e rasteve. Këto pesë shkaqe përfshijnë: **(1) Ndikimin Politik:** ndikimin e paligjshëm të politikanëve të cilët e keqpërdorin fuqinë e tyre për të ndikuar në rezultatet e rasteve përmes kërcënimeve apo frikësimit; **(2) Ndikimi i palëve në proces:** nepotizmi, përdorimi i pasurisë personale dhe lidhjeve për t'i ndikuar rezultatet e rasteve; **(3) Motivimi financiar i gjykatësve:** mitosja direkte e gjykatësve për të gjykuar në favor të palës e cila ka ofruar mito; **(4) Gjykata joefikase me burime të kufizuara:** burimet e kufizuara njerëzore të cilat e ngadalësojnë procedimin e rasteve dhe hapin mundësi për “lyerjen e zingjirëve” përmes mitos apo kompensimit; **(5) Ndikimi i Avokatit:** komunikimi i avokatit ex parte me gjykatësin e caktuar të rastit dhe ndikimi në verdikt, apo përdorimi i avokatit si ndërmjetës për të ekzekutuar pagesën e mitos me rastin e gjykatësit nga palët e involvuara.

Pjesëmarrësit e DFG u shprehën se të gjitha opsionet e dhëna janë të ndërlidhura në mes vete, si për shembull nëse motivimi financiar i gjykatësit është arsyeja prapa korrupsionit, ndikimi i palëve në proces është prapa tij, apo nëse ndikimi politik është shkak i korrupsionit, atëherë ndikimi i palëve në proces është përsëri shkaku kryesor prapa tij, dhe kështu me radhë.

Gjithashtu, përmes pjesës tjetër të pyetjeve në këtë seksion, respondentët u pyetën nëse ata personalisht kanë qenë të involvuar në raste të kërkimit apo dhënies së mitos nga punëtorët e gjykatës për ta përshpejtuar rastin apo për verdikt në favorin e tyre.

7.1 SHKAQET E KORRUPSIONIT

Pesë shkaqet vijuese të korrupsionit janë ofruar si opsione që të klasifikohen nga respondentët për rëndësinë e tyre për të shkaktuar korrupsion në gjyqësor, sipas perceptimit dhe përvojës së tyre. Ndikimi i paligjshëm politik ishte shkak më i rëndësishëm i korrupsionit në të gjitha Gjykatat Themelore, me përjashtim të Prizrenit, ku pjesa më e madhe e respondentëve (36.7%) deklaruan se ndikimi i avokatëve ishte shkak më i madh i korrupsionit. Përgjithësisht, shkaqet tjera të korrupsionit (ndikimi i palëve në proces, motivimi financiar i gjykatësve, gjykata joefikase me burime të kufizuara dhe ndikimi i avokatëve) ishin raportuar shumë më pak si shkak më i rëndësishëm i korrupsionit krahasuar me ndikimin politik. Është e rëndësishme të vërehet se palët në procedurë dhe avokatët/përfaqësuesit e autorizuar kishin në përgjithësi pikëpamje të njëjta kur u pyetën për shkakun më të rëndësishëm të korrupsionit. Megjithatë, avokatët/përfaqësuesit e autorizuar të cilët merren

⁷ Raporti i Progresit për Kosovë 2018, Komisioni Evropian. Më shumë në: <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-kosovo-report.pdf>

më shpesh me raste të ndryshme, identifikuan *ndikimin politik* si shkakun më të rëndësishëm të korrupsionit pak më lartë se sa palët në proces.

Tabela 28. Shkakun më të rëndësishëm të korrupsionit në mesin e 5 opsioneve, ndaras për palët në procedurë dhe avokatët apo personat e autorizuar.

Në opinionin tuaj, cili është shkakun më të rëndësishëm të korrupsionit?

	Ndikimi Politik	Ndikimi i palëve në proces	Motivimi financiar i gjykatësve	Gjykatë joefikase me burime të kufizuara	Ndikimi i avokatëve
Pala në procedurë	40.95%	15.43%	14.84%	13.80%	14.99%
Avokati apo përfaqësuesi i autorizuar	48.78%	17.89%	10.57%	13.82%	8.94%

Në linjë me të gjeturat e agreguara, respondentët nga Prishtina kanë zgjedhur ndikimin politik si shkakun më të rëndësishëm të korrupsionit me 32%, pjesa tjetër e përgjigjeve janë të ndara gati barazi në mes të katër opsioneve tjera të ofruara. Kjo gjetje u hulumtua më thellë në DFG, ku u elaborua se arsyeja pse ndikimi politik është parë si shkakun kryesor të korrupsionit është sepse ekziston një besim i gjerë se gjykatësit të cilët ndjekin ngritje në pozitë janë të ndikuar nga forcat politike të cilat kanë ndikim në proceset e avansimit të tyre në gjykata të instancave më të larta. Kështu, korrupsioni në këtë Gjykatë është kryesisht i këtij këmbimi të favoreve ku në rastet kur një nga palët ka lidhje politike, gjykimi në favor të asaj pale shpërblehet me ofrim punësimi për anëtarët e familjes dhe të njohurve të tyre, favore ekonomike, ngritje në pozitë e kështu me radhë. Kjo vërteton të gjeturat e hulumtimit ku respondentët thanë se ndikimet politike janë shkakun kryesor të korrupsionit.

Respondentët në Gjilan gjithashtu ranguan ndikimin politik si shkakun më të rëndësishëm të korrupsionit, (54%). Katër opsionet e mbetura morën gati një shpërndarje të barabartë të përgjigjeve. Ndonëse hulumtimi prezantoi një përqindje të ulët (1%) të shfrytëzuesve të shërbimeve të gjykatës që kanë përjetuar personalisht korrupsion, pjesëmarrësit në këtë DFG thanë se korrupsioni ndodhë shumë më shpesh, ndonëse vetëm një respondent tha se atij/asaj i është kërkuar mito, dhe dy respondent thanë se ata u kanë dhënë mito zyrtarëve të gjykatës, të tjerët dinin raste, por nuk ishin personalisht të involvuar. Të paraqitura këtu si evidenca të shkurtëra në vijim janë përvojat e pjesëmarrësve të DFG: Një numër i tyre deklaruan se mitot në këtë gjykatë janë të pranuar apo kërkuar nga stafi administrativ i gjykatës, derisa gjykatësit kryesisht kërkojnë favore në vend të mitos. Një pjesëmarrës ndau përvojën e saj lidhur me rastin e divorcit – në rastet kur ajo vizitoi gjykatën për të zbuluar pse rasti i saj nuk po zgjidhej dhe u takua me një zyrtarë përgjegjës të gjykatës përgjegjës për zbatimin e rastit të saj, i njëjti person ishte parë më pas disa herë duke ngrënë darkë me ish burrin e saj. Një avokat pjesëmarrës përmendi një rast për të cilin ai mendonte se e kishte fituar me meritë, por më vonë mësoi se klienti i tij kishte paguar një staf administrativ për ta ndikuar rezultatin, pra një situatë për të cilën vet avokati i çështjes nuk ishte i vetëdijshëm.

Hulumtimi tregon se mbi 50% e respondentëve nga Mitrovica konsiderojnë ndikimin politik të jetë shkaku kryesor i korrupsionit dhe 25% konsiderojnë ndikimin e palëve në proces të jetë shkaku i dytë më i përhapur. Pjesëmarrësit e DFG u pajtuan me këto të dhëna, dhe kjo për më tepër tregon se korrupsioni ka evoluar – është bërë më i sofistikuar – në vend të parave, tani ka marrë formën e këmbit të favoreve dhe ndikimit.

Respondentët në Gjakovë e kanë ranguar ndikimin politik si shkakun kryesor të korrupsionit (39% e tyre) dhe ndikimin e palëve në proces si shkakun e dytë më të rëndësishëm (28%). Në DFG, shumica e pjesëmarrësve janë shprehur që kjo Gjykatë karakterizohet me vendime të "befasishme" të gjyqtarëve të caktuar e që i bënë qytetarët të mendojnë që korrupsioni mund të luaj rol. Sipas pjesëmarrësve në diskutim, vendimet e Gjykatës nuk janë gjithmonë të drejta dhe pjesëmarrësit ia atribuon këtë kulturës në Gjakovë, ku emri i familjes (emri i "respektuar" i familjes sipas standardeve të mentalitetit lokal) është shumë i rëndësishëm dhe nganjëherë gjyqtarët fokusohen në këtë në vend të provave për rastin. Ata e bëjnë dallimin e palëve që vijnë nga familjet e "privileguara" duke u dhënë atyre gjopa të vogla, e në disa raste kjo reflektohet edhe në vetë përfundimin e rastit.

Shumica e shfrytëzuesve të shërbimeve të Gjykatës Themelore të Ferizajt (54%) e konsiderojnë ndikimin politik si shkakun kryesor të korrupsionit, në përgjithësi. Megjithatë, i vetmi rast publik i korrupsionit në këtë gjykatë, është ai i vitit 2010, kur një gjykatës kishte pranuar ryshfet prej 20 eurosh. Është theksuar që palët (qytetarët që janë palë në procedurë gjyqësore) janë ata të cilët mendojnë se për të zgjidhur një rast shpejt dhe në favor të tyre duhet të paguajnë ryshfet, mirëpo në praktikë askush nuk ka pranuar të ketë përjetuar një vepër të tillë në praktikë në këtë gjykatë. Pjesëmarrësit kanë deklaruar që ata nuk janë të informuar për veprimet dhe aktivitetet e gjykatës (duke përfshirë strukturën, proceset, bazën e gjykimeve dhe logjikën e vendimeve) dhe në mungesë të këtyre informacioneve, ngrisin sinjale për korrupsion. Ndikimi politik është konsideruar si faktori më i rëndësishëm që kontribuon në korrupsion në sistemin e drejtësisë, e që është ndërtuar më shumë mbi atë që kanë dëgjuar e jo nga përvoja personale.

Përdoruesit e Gjykatës Themelore në Pejë kanë bindjen më të madhe se ndikimi politik është shkaku kryesor i korrupsionit në gjyqësor me 75% të respondentëve të pyetësorit që kanë ranguar këtë si faktorin kryesor të korrupsionit. Pjesëmarrësit e DFG janë pajtuar me gjetjet, duke deklaruar që të gjitha opsionet e ofruara si shkaqe, janë të udhëhequra dhe të lidhura me ndikimin politik. Termi "drejtësi selektive" është përdorur për të përshkruar se si sistemi gjyqësor favorizon individët që gëzojnë lidhje politike dhe me këtë vjen fuqia dhe ndikimi. Pjesëmarrësit nuk janë befasuar që asnjë nga respondentët nuk ka pranuar të ketë dhënë apo t'i jetë kërkuar ryshfet ndërsa njëri nga avokatët e ka pranuar që shumë klientë e shohin ryshfetin si rrugë për të zgjidhur rastin më shpejt. Prandaj, me këtë informatë, mund të arrijmë në përfundimin që hulumtime/studime të mëtutjeshme janë të nevojshme për të parë nëse ryshfeti "quid pro quo" në pritje të kthimit të favorit ka përfunduar dhe nëse është zëvendësuar plotësisht me ndikimin e subjekteve politike dhe të palëve, ngase është e qartë nga përvoja e pjesëmarrësve të DFG që palët dhe avokatët vazhdojnë ta konsiderojnë përfshirjen në ryshfet në disa raste. Gjithashtu, studim i mëtutjeshëm është i nevojshëm për të parë nëse palët që nuk kanë lidhje politike apo familjare lihen me opsionin e vetëm për të përdorur ryshfetin për të ndikuar në shpejtimin e procedurës gjyqësore apo në vendim.

Në fund, vetëm shfrytëzuesit e Gjykatës Themelore në Prizren e rangojnë ndikimin e avokatëve si shkakun primar të korrupsionit në gjyqësor. Pjesëmarrësit e DFG janë pajtuar që ndikimi i avokatëve është një nga shkaqet kryesore të korrupsionit, mirëpo, ata mendojnë që politika ka ndikim më të zgjeruar në korrupsion dhe që këto dy shkaqe janë ngushtë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Kur janë

pyetur për të elaboruar rreth kësaj gjetjeje, pjesëmarrësit e kanë pranuar që Prizreni është qytet i vogël dhe që avokatët që njohin njerëz, i përdorin këto raporte miqësore apo lidhje familjare për të siguruar informacione që nuk janë të qasshme për të tjerët dhe që i përshpejtojnë rastet që ata i përfaqësojnë.

Tabela 29. Shkaku kryesor i korrupsionit në mes të pesë opsioneve të ofruara, sipas gjykatave themelore

Sipas mendimit tuaj, cili është shkaku kryesor i korrupsionit?

	Ndikimi politik	Ndikimi i palëve në proces	Motivimi financiar i gjyqtarëve	Gjykatë joefikase me burime të kufizuara	Ndikimi i avokatëve
Prishtinë	32.75%	18.42%	16.67%	16.37%	15.79%
Mitrovicë	53.73%	22.39%	10.45%	4.48%	8.96%
Prizren	16.18%	2.94%	13.24%	30.88%	36.76%
Pejë	75.00%	4.17%	12.5%	4.17%	4.17%
Ferizaj	53.98%	17.7%	10.62%	11.50%	6.19%
Gjakovë	38.57%	22.86%	12.86%	10.00%	15.71%
Gjilan	53.85%	10.77%	15.38%	10.77%	9.23%

Kur janë pyetur se cili është shkaku i dytë më i rëndësishëm i korrupsionit, ndikimi i palëve në proces dhe motivimi financiar i gjyqtarëve janë përmendur pak më shumë se arsyt e tjera për korrupsion. Një ndarje relativisht e barabartë e shkaqeve është bërë me rastin e dhënies së përgjigjes se cili është shkaku i tretë, katërt dhe pestë i korrupsionit. Figura më poshtë ofron këto përgjigje.

Tabela 30. Shkaku i dytë më i rëndësishëm i korrupsionit në mesin e pesë opsioneve të ofruara, sipas gjykatave themelore

Sipas mendimit tuaj, cili është shkaku i dytë më i rëndësishëm i korrupsionit?

	Ndikimi politik	Ndikimi i palëve në proces	Motivimi financiar i gjyqtarëve	Gjykatë joefikase me burime të kufizuara	Ndikimi i avokatëve
Prishtinë	13.58%	24.38%	32.1%	21.91%	8.02%

	Ndikimi politik	Ndikimi i palëve në proces	Motivimi financiar i gjyqtarëve	Gjykatë joefikase me burime të kufizuara	Ndikimi i avokatëve
Mitrovicë	18.64%	25.42%	15.25%	16.95%	23.73%
Prizren	25.00%	19.12%	23.53%	11.76%	20.59%
Pejë	38.78%	28.57%	14.29%	12.24%	6.12%
Ferizaj	18.56%	18.56%	22.68%	16.49%	23.71%
Gjakovë	13.04%	27.54%	23.19%	20.29%	15.94%
Gjilan	11.11%	18.52%	29.63%	24.07%	16.67%

Tabela 31. Shkaku i tretë më i rëndësishëm i korrupsionit në mesin e pesë opsioneve të ofruara, sipas gjykatave themelore

Sipas mendimit tuaj, cili është shkaku i tretë më i rëndësishëm i korrupsionit?

	Ndikimi politik	Ndikimi i palëve në proces	Motivi financiar i gjyqtarëve	Gjykatë joefikase me burime të kufizuara	Ndikimi i avokatëve
Prishtinë	22.22%	30.33%	20.42%	16.52%	10.51%
Mitrovicë	20.97%	32.26%	20.97%	19.35%	6.45%
Prizren	25.00%	35.29%	16.18%	13.24%	10.29%
Pejë	0.00%	35.29%	8.82%	26.47%	29.41%
Ferizaj	10.58%	27.88%	26.92%	14.42%	20.19%
Gjakovë	37.14%	27.14%	22.86%	8.57%	4.29%
Gjilan	25.00%	23.08	19.23%	25.00%	7.69%

Tabela 32. Shkaku i katërt më i rëndësishëm i korrupsionit në mesin e pesë opsioneve të ofruara, sipas gjykatave themelore

Sipas mendimit tuaj, cili është shkaku i katërt më i rëndësishëm i korrupsionit?

	Ndikimi politik	Ndikimi i palëve në proces	Motivimi financiar i gjyqtarëve	Gjykatë joefikase me burime të kufizuara	Ndikimi i avokatëve
Prishtinë	31.34%	12.84%	12.24%	20.30%	23.28%
Mitrovicë	11.86%	15.25%	38.98%	22.03%	11.86%
Prizren	4.41%	16.18%	20.59%	32.35%	26.47%
Pejë	18.18%	20.45%	15.91%	20.45%	25.00%
Ferizaj	16.67%	25.93%	23.15%	21.30%	12.96%
Gjakovë	2.86%	12.86%	21.43%	37.14%	25.71%
Gjilan	6.00%	16.00%	12.00%	12.00%	54.00%

Tabela 33. Shkaku i pestë më i rëndësishëm i korrupsionit në mesin e pesë opsioneve të ofruara, sipas gjykatave themelore

Sipas mendimit tuaj, cili është shkaku i pestë më i rëndësishëm i korrupsionit?

	Ndikimi politik	Ndikimi i palëve në proces	Motivimi financiar i gjyqtarëve	Gjykatë joefikase me burime të kufizuara	Ndikimi i avokatëve
Prishtinë	6.42%	17.43%	20.18%	19.88%	36.09%
Mitrovicë	1.69%	11.86%	16.95%	28.81%	40.68%
Prizren	29.41%	26.47%	26.47%	11.76%	5.88%
Pejë	15.91%	34.09%	31.82%	9.09%	9.09%
Ferizaj	11.46%	23.96%	26.04%	21.88%	16.67%
Gjakovë	8.70%	10.14%	20.29%	24.64%	36.23%
Gjilan	30.77%	25.00%	15.38%	21.15%	7.69%

7.2 RYSHFETI

Mbizotërimi i ryshfetit si formë e korrupsionit është një indikator i rëndësishëm në vlerësimin e ekzistimit dhe të shkallës së korrupsionit në sistemin e drejtësisë. Nga numri total prej 817 responentëve, 38 sosh apo 4.51% kanë raportuar se u është kërkuar ryshfet nga gjykatës apo punëtor i gjykatës.

Tabela 34. Përqindja dhe numri i pjesëmarrësve që kanë raportuar se u është kërkuar ryshfet nga një gjykatës apo punëtor i gjykatës

A u është kërkuar ndonjëherë të jepni ryshfet nga ndonjë gjykatës apo punëtor i gjykatës?

Po	Jo
4.5%	95.49%

35% e responentëve nga Prizreni u përgjigjën se u është kërkuar ryshfet. Kjo gjykatë themelore duket të ketë problemin më të madh me kërkim dhe dhënje të ryshfetit. Kjo shifër në Prizren në aspekt të përqindjes është tetë herë më e lartë se Gjykata e radhitur pas saj – Gjykata Themelore e Mitrovicës (me 4.6% të responentëve që kanë deklaruar se u është kërkuar ryshfet). Responentët nga Gjakova dhe Peja nuk kanë raportuar asnjë rast kur u është kërkuar të japin ryshfet. Shumicës së pjesëmarrësve u është kërkuar të japin ryshfet në mënyrë që vendimi të shkoj në favor të tyre apo që të përshpejtohet procedura gjyqësore, ndërsa një pjesë e vogël kanë raportuar për raste kur u është kërkuar ryshfet për të nxjerrë ndonjë dokument.

Është shqetësuese që një e treta e responentëve që kanë raportuar që u është kërkuar ryshfet në Prizren, kanë deklartuar që kërkesa u është bërë për të vendosur në favor të tyre për rastin. Përderisa pesë nga shtatë rastet e kërkesave të tilla në Prishtinë kanë qenë me qëllim të përshpejtimit të procesit dhe dy për të vendosur në favor të tyre. Figura e mëposhtme tregon numrin e responentëve që kanë raportuar se u është kërkuar ryshfet, arsyen dhe Gjykatën se ku ka ndodhur kjo.

Tabela 35. Arsyet pse u është kërkuar responentëve të japin ryshfet nga gjykatës apo punëtor i gjykatës

Nëse po, pse?

Për të përshpejtuar procesin	Për të marrë dokumentin e nevojshëm	Për të vendosur në favor të tyre për rastin	Tjetër
34.21%	5.26%	50.00%	10.53%

Sa i përket asaj nëse kanë dhënë ryshfet apo jo, figura e mëposhtme tregon numrin dhe përqindjen e pjesëmarrësve që kanë raportuar t'i kenë dhënë ryshfet një gjykatësi apo punëtor i gjykatës. Ngjashëm me rastin e kërkesës për ryshfet, responentët nga Prizreni kanë raportuar numrin më të madh të dhënies së ryshfetit, të ndjekur nga Gjykata Themelore e Prishtinës.

Tabela 36. Përqindja e shfrytëzuesve të gjykatave që u kanë dhënë ryshfet ndonjë gjykatësi apo punëtori të gjykatës

A i keni dhënë ndonjëherë ryshfet ndonjë gjykatësi apo punëtori të gjykatës?

Po	Jo
2.61%	97.39%

Figura e mëposhtme tregon përqindjen e pjesëmarrësve që kanë dhënë ryshfet zyrtarëve të gjykatave dhe që e kanë identifikuar pozitën e personit që e ka pranuar ryshfetin. Shumica e pjesëmarrësve e kanë vendosur marrësin e ryshfetin në katëtorinë Tjetër.

Tabela 37. Pozita e personit që i është dhënë ryshfeti

What position did the person you bribed have?

Gjykatës	Referent	Administrative	Tjetër
18.18%	9.09%	0%	72.73%

Duke e pasur parasysh që numri i respondentëve që e kanë pranuar se kanë dhënë ryshfet është i vogël (vetëm 2.61%), ndarja e rezultateve e paraqitur më poshtë sipas secilës Gjykatë Themelore është bërë me numra në vend të përqindjeve. Respondentët kanë raportuar dhënien të ryshfetit gjykatësit në tre raste në Prizren dhe në një rast në Prishtinë. Asnjë nga personat nuk ka treguar që i ka dhënë ryshfet një personi që mban pozitë administrative në Gjykatë.

Tabela 38. Pozita e personit që ka marrë ryshfet, sipas Gjykatës

Çfarë pozite ka pasur personi të cilit i keni dhënë ryshfet?

	Gjykatës	Referent	Administrative	Tjetër
Prishtinë	1	0	0	2
Mitrovicë	0	1	0	0
Prizren	3	0	0	13
Pejë	0	0	0	0

	Gjykatës	Referent	Administrative	Tjetër
Ferizaj	0	0	0	0
Gjakovë	0	0	0	0
Gjilan	0	1	0	1

7.3 RENDITJA E PËRGJITHSHME E MBIZOTËRIMIT TË RYSHFETIT

Renditja sipas aspektit të mbizotërimit apo shpeshtësisë së dhënjes/kërkimit të ryshfetit sipas mesatares së përgjigjeve të dhëna nga të gjithë pjesëmarrësit në secilën gjykatë themelore, duke u bazuar në dy pyetjet në vijim:

1. A u është kërkuar ndonjëherë ryshfet nga ndonjë gjykatës apo punëtor i gjykatës?
2. A i keni dhënë ndonjëherë ryshfet ndonjë gjykatësi apo punëtor?

Figura 39. Renditja e Gjykatave Themelore sipas mbizotërimit/shpeshtësisë së ryshfetit

Gjykata Themelore	Renditja
Gjakovë	1
Pejë	1
Ferizaj	3
Prishtinë	4
Gjilan	5
Mitrovicë	6
Prizren	7

**Renditja e Gjykatave Themelore sipas përgjigjeve të respondentëve, ku 1 është krahasimisht më mirë se Gjykatat e tjera të renditura dhe 7 është krahasimisht më dobët se Gjykatat e tjera të renditura.*

Edhe gjykata themelore e Gjakovës edhe ajo e Pejës janë radhitur të parat sa i përket shpeshtësisë së korrupsionit, ngase respondentët nuk kanë raportuar asnjë rast të ryshfetit. Radhitja e gjykatave nuk përfaqëson numrin e rasteve të raportuara të korrupsionit por tregon frekuencën në mes të përgjigjeve pozitive dhe negative. Sa më e ulët përqindja, aq më i mirë është rangimi.

8 REKOMANDIME PËR PËRMIRËSIM

Bazuar në të gjetuar e këtij punimi, rekomandimet për përmirësim të kualitetit të shërbimeve të ofruara nga Gjykatat Themelore janë të grupuara në fushat tematike si në vijim:

Përmirësimi i qasjes në informacion përkitazi me rastet dhe aktivitetet e Gjykatës

Gjykata Themelore e Prishtinës duhet të bëjë informacionet rreth rasteve të qasshme për palët dhe përfaqësuesit e tyre ligjor apo avokatët në ueb faqen e saj zyrtare, duke përfshirë statusin e rastet, gjykatësin e caktuar në raste dhe orarin e seancave gjyqësore. Informacionet e përgjithshme rreth aktiviteteve të Gjykatës duhet të jenë të qasshme në çdo kohë në ueb faqe si dhe në ndërtesën e Gjykatës, si dhe të ofrohen në atë mënyrë që të jenë të dobishme për shfrytëzuesit e saj. Kjo Gjykatë duhet të përmirësojë nivelin e ofrimit të përgjigjeve përmes e-mailit dhe telefonit, ngase aktualisht, të vetmet kanale komunikimi të palëve janë shkresat zyrtare apo posta tradicionale. Po ashtu, duhet të përmirësohet edhe shenjëzimi, ashtu që të lehtësohet identifikimi i ndërtesave dhe gjetja e zyrave apo gjykatoreve në rast të nevojës nga shfrytëzuesit e gjykatës. Ngjashëm, Gjykata Themelore në Gjilan dhe ajo në Mitrovicë duhet të përmirësojnë qasjen e qytetarëve në informacion dhe komunikimin dykahor (përmes telefonit dhe e-mailit) në vend që qytetarët të shkojnë personalisht në gjykatë për të marrë informacione. Gjithashtu, Gjykata Themelore në Pejë duhet të ofrojë qasje të barabartë në informacion për të gjithë shfrytëzuesit e gjykatave, në vend të nevojës për të kërkuar lidhje personale apo ndikim politik për të marrë një informacion nga Gjykata.

Gjykata Themelore e Ferizaj duhet të punojë në ngritjen e transparencës për aktivitetet e saja ditore përmes (1) informimit të publikut për punën e saj dhe (2) rritjes së qasjes në informacion për ata që aktivisht kërkojnë informacion nga Gjykata. Rekomandohet fuqishëm që këto gjykata të ofrojnë bileta numerike që përcaktojnë radhën e pritjes, si dhe broshura/fletëpalosje me pyetje të shpeshta dhe informacione të përgjithshme për shërbimet që ofrohen nga Gjykata.

Rritja e efikasitetit në procesimin e rasteve

Gjykata themelore në Mitrovicë duhet të rrisë efikasitetin në procesimin e rasteve ngase rangohet si e fundit në aspekt të efikasitetit dhe drejtësisë. Më konkretisht, gjykatësit duhet të shkruajnë vendimet e tyre në mënyrë më të qartë, të reflektojnë më mirë në arsyetimet dhe bazën ligjore të vendimit dhe t'i bëjnë ato më vështirë të rrëzueshme nga gjykata e apelit. Për më tepër, numri i gjykatësve duhet të rritet si një faktor i rëndësishëm në përmirësimin e efikasitetit të gjykatave në uljen e numrit të lëndëve të pazgjidhura. Ngjashëm, gjykata themelore në Gjakovë duhet të ndërmarrë masa në mënyrën e procesimit, ngase efikasiteti i saj po dëmtohet nga numri i madh i lëndëve që transferohen nga gjykatat e instancave më të larta. Gjykata themelore e Prishtinës, Prizrenit, Pejës dhe Gjilanit duhet të punësojnë më shumë gjykatës për të përshpejtuar procesimin e rasteve, e veçanërisht në Departamentin e Lëndëve Civile, ngase numri i gjykatësve është i ulët në masë alarmante krahasuar me numrin e lëndëve që presin për tu zgjidhur.

Masat e kontrollit për ryshfetin

Gjykatat themelore të Prizrenit, Mitrovicës dhe Gjilanit duhet të adresojnë çështjen e korrupsionit përmes (1) krijimit të masave shtesë të kontrollit dhe (2) ndërmarrjes së masave për parandalimin e kësaj dukurie. Mënyrat se si mund të arrihet kjo potencialisht janë: ofrimi i numrave pa pagesë dhe kutive të ankesave në korridoret e gjykatave ku shfrytëzuesit në mënyrë anonime mund të raportojnë kërkesat për ryshfet. Po ashtu duhet të ndërmarrë masa për të parandaluar këtë përmes ofrimit të trajnimeve obligative mbi etikën për të gjithë gjykatësit dhe stafin e gjykatës. Ata po ashtu duhet të ofrojnë për të gjithë stafin, duke përfshirë edhe gjykatësit trajnime për zhvillim profesional, të miratojnë politika më të fuqishme për mbajtjen e gjykatësve llogaridhënës me standarde edhe më të larta si dhe të vendosin edhe masa të mbikqyrjes nga institucione mbikqyrëse si Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Qasje e barabartë dhe e drejtë për të gjithë

Gjykata Themelore në Gjakovë duhet të sigurohet që drejtësia u shërben të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë dhe pa favorizime, pa marrë parasysh emrin e familjes apo ndikimin që ata mund të kenë përmes lidhjeve politike apo lidhjeve të tjera. Gjykatësit duhet të shkruajnë vendime mirë të arsyetuara që shpjegojnë pse është marrë vendimi siç është marrë. Ngjashëm, gjykata themelore e Pejës duhet të trajtojë të gjithë shfrytëzuesit në mënyrë të barabartë dhe pa favorizime. Kjo gjykatë duhet së pari të ndërmarrë masa për të identifikuar se sa shpesh ndodh kjo lloj sjelljeje nga stafi i gjykatës përmes bashkëpunimit me shfrytëzuesit e gjykatave (përmes pyetësorëve dhe/apo kutive të ankesave) dhe ndërmarrjes së masave për adresimin e çështjes përmes trajnimit të stafit si dhe masave disiplinore. Gjykata themelore në Ferizaj duhet të përmirësojë zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve, ngase qytetarët e saj, pra shfrytëzuesit e gjykatës, përfshijnë edhe komunitete tjera etnike, ndërsa gjykata themelore në Prizren duhet të sigurohet që të gjithë avokatët marrin trajtimin e barabartë nga gjykatësit. Në fund, gjykata themelore në Prishtinë duhet të punojë në përmirësimin e trajtimit të qytetarëve nga ana e punëtorëve të gjykatës, ngase kjo gjykatë është ranguar në pozitën më të keqe sa i përket nivelit të mirësjelljes dhe respektit që shfrytëzuesit e gjykatës marrin aty.

Rekomandimet për përmirësime specifike për gjendjen e secilës gjykatë, janë të detajuara më poshtë.

Gjykata themelore në Prishtinë duhet të:

- Bëjë të qasshme informacionet rreth rasteve, duke përfshirë statutin e rastit, gjykatësin e caktuar në rast dhe orarin e seances gjyqësore për palët dhe avokatët/përfaqësuesit ligjor në ueb faqe;
- Ofrojë informacione të përgjithshme për aktivitetet e gjykatës në faqen e saj;
- Përmirësojë nivelin e ofrimit të përgjigjeve përmes e-mailit dhe telefonit;
- Përmirësojë shenjëzimin në ndërtesat e gjykatës në mënyrë që t'u lehtësojë shfrytëzuesve identifikimin e ndërtesës dhe gjetjen e zyrave apo gjykatoreve që ju duhen;
- Përmirësojë nivelin e trajtimit që u bëhet qytetarëve nga ana e punëtorëve të gjykatës;

Gjykata themelore e Ferizajt duhet të:

- Risë transparencën për aktivitetet e saja ditore përmes (1) informimit të publikut për punën e saj dhe (2) rritjen e qasjes në informacion për ata që në mënyrë aktive kërkojnë informacione nga gjykata;
- Përmirësojë zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve, ngase qytetarët e Ferizajt, pra shfrytëzuesit e gjykatës përfshijnë edhe minoritetet etnike;

Gjykata themelore në Gjilan duhet të:

- Përmirësojë qasjen e qytetarëve në informacion dhe zhvillojë komunikimin dy-kahor (përmes telefonit dhe e-mailit) në vend që palët të detyrohen të shkojnë personalisht në gjykatë për të kërkuar informacione.
- Rrisë numrin e gjyqtarëve për të përshpejtuar procesimin e rasteve në Departamentin Civil, ngase numri i gjyqtarëve është tejet i ulët krahasuar me numrin e rasteve që kërkojnë të zgjidhen;
- Të adresohet çështja e korrupsionit përmes: (1) krijimit të masave shtesë të kontrollit për ryshfet dhe (2) ndërmarrjen e masave për të parandaluar këtë dukuri, përmes:
 - Ofrimit të numrave të telefonit pa pagesë dhe kutive të ankesave në korridoret e gjykatave për të raportuar në mënyrë anonime për kërkesat për ryshfet;
 - Ofrim të trajnimeve obligative për etikë për gjyqtarët dhe të gjithë stafin;
 - Trajnimit të të gjithë punëtorëve të gjykatës, duke përfshirë gjyqtarët për zhvillim profesional;
 - Miratimit të politikave më të fuqishme për llogaridhënie të gjyqtarëve sipas standardeve më të larta; dhe
 - Marrjes së masave mbikqyrëse nga një institucion mbikqyrës, si për shembull Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Gjykata themelore e Gjakovës duhet të:

- Ndërmerr veprimeve të nevojshme për mënyrën e procesimit të rasteve, ngase efikasiteti i tyre po dëmtohet nga numri i madh i rasteve që janë transferuar nga instancat më të larta gjyqësore;
- Sigurohet që drejtësia u shërben të gjithë qytetarëve në mënyrë të barabartë dhe pa favorizime, pa marrë parasysh emrin e familjes apo ndikimin që mund të kenë përmes lidhjeve politike apo të natyrave të tjera;
- Sigurohet që gjyqtarët duhet të shkruajnë vendime mirë të arsyetuara që shpjegojnë se pse është marrë një vendim i caktuar;

Gjykata themelore e Pejës duhet të:

- Ofrtojë qasje të barabartë për të gjithë shfrytëzuesit, në vend që të përdoren lidhjet personale të dikujt apo ndikimi politik për të siguruar informacionin nga gjykata;
- Rrisë numrin e gjyqtarëve për të përshpejtuar procesimin e rasteve në Departamentin Civil, ngase numri i gjyqtarëve është tejet i ulët krahasuar me numrin e rasteve që kërkojnë të zgjidhen;
- Sigurohet që të gjithë punonjësit e saj (gjyqtarët dhe administratë) i trajtojnë në mënyrë të barabartë dhe pa favorizim të gjithë shfrytëzuesit përmes: (1) identifikimit të frekuencës apo shpeshësisë së ndodhjes së këtij fenomeni dhe (2) ndërmarrjen e masave për tu mundësuar qytetarëve që ta raportojnë atë dhe (3) ndërmarrjen e masave për ta adresuar përmes trajnimit të stafit dhe marrjes së masave disiplinore.

Gjykata themelore në Mitrovicë duhet të:

- Përmirësojë qasjen e qytetarëve në informacion dhe zhvillojë komunikimin dy-kahor (përmes telefonit dhe e-mailit) në vend që palët të detyrohen të shkojnë personalisht në gjykatë për të kërkuar informacione.
- Të rrisë efikasitetin në procesimin e rasteve:
 - Në veçanti, gjyqtarët duhet të shkruajnë vendimet e tyre në mënyrë më të qartë, të reflektojnë më mirë në arsyetimin e vendimit dhe bazën ligjore për marrjen e vendimit, të vështirësojnë kthimin e rastit mbrapa nga Gjykata e Apelit;
 - Të rrisë numrin e gjyqtarëve si një faktor i rëndësishëm në përmirësimin e efikasitetit të gjykatës në uljen e numrit të rasteve të pazgjidhura;

- Të adresohet çështja e korrupsionit përmes: (1) krijimit të masave shtesë të kontrollit për ryshfet dhe (2) ndërmarrjen e masave për të parandaluar këtë dukuri, përmes:
 - Ofrimit të numrave të telefonit pa pagesë dhe kutive të ankesave në korridoret e gjykatave për të raportuar në mënyrë anonime për kërkesat për ryshfet;
 - Ofrimt të trajnimeve obligative për etikë për gjyqtarët dhe të gjithë stafin;
 - Trajnimit të të gjithë punëtorëve të gjykatës, duke përfshirë gjyqtarët për zhvillim profesional;
 - Miratimit të politikave më të fuqishme për llogaridhënie të gjyqtarëve sipas standardeve më të larta; dhe
 - Marrjes së masave mbikqyrëse nga një institucion mbikqyrës, si për shembull Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Gjykata themelore e Prizrenit duhet të:

- Risë numrin e gjyqtarëve për të përsheptuar procesimin e rasteve në Departamentin Civil, ngase numri i gjyqtarëve është tejet i ulët krahasuar me numrin e rasteve që kërkojnë të zgjidhen;
- Adresojë çështjen e korrupsionit përmes: (1) krijimit të masave shtesë të kontrollit për ryshfet dhe (2) ndërmarrjes së masave për të parandaluar këtë dukuri, përmes:
 - Ofrimit të numrave të telefonit pa pagesë dhe kutive të ankesave në korridoret e gjykatave për të raportuar në mënyrë anonime për kërkesat për ryshfet;
 - Ofrimt të trajnimeve obligative për etikë për gjyqtarët dhe të gjithë stafin;
 - Trajnimit të të gjithë punëtorëve të gjykatës, duke përfshirë gjyqtarët për zhvillim profesional;
 - Miratimit të politikave më të fuqishme për llogaridhënie të gjyqtarëve sipas standardeve më të larta; dhe
 - Marrjes së masave mbikqyrëse nga një institucion mbikqyrës, si për shembull Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
- Sigurohet që të gjithë avokatët trajtohen në mënyrë të barabartë nga gjyqtarët;

9 SHTOJCA I

REKOMANDIME DHE ZOTIME NGA TRYEZAT

Gjetjet e studimit “Transparenca dhe Efikasiteti i Gjykatave Themelore të Kosovës” dhe të dy raporteve përcjellëse “Vlerësimi i Qytetarëve mbi Shërbimet e Gjykatave Themelore” dhe “Shërbimet e Gjykatave Themelore Sipas Vlerësimit të Avokatëve” janë prezantuar dhe diskutuar në gjashtë tryeza diskutimi. Të pranishëm në këto ngjarje kanë qenë Kryetarët apo nën-Kryetarët e Gjykatave Themelore të cilët janë zotuar se do të angazhohen në fusha të caktuara për përmirësim të kualitetit të shërbimeve të gjykatave. Pjesëmarrës tjerë kanë qenë gjykatës, administratorë, avokatë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët kanë dhënë rekomandimet e tyre për sa i përket angazhimit të gjykatave në adresimin e çështjeve që dalin nga ky raport.

Rekomandimet dhe zotimet e dhëna në tryeza, për secilën gjykatë themelore, janë të paraqitura si më poshtë:

Gj. Th. Ferizaj:

- Kryetari i gjykatës u zotua se do të bëhet hartimi i një plani të punës, qëllimi i të cilit është avancimi i rrjedhës së informacionit tek publiku;
- Kryetari u zotua se do t'i marrë parasysh rekomandimet për lehtësim të raportimit të korrupsionit në gjykatë, qoftë përmes kutisë së ankesave apo edhe ofrimit të numrave të telefonit ku thirrja është pa pagesë.

Gj. Th. Gjilan:

- Kryetari i gjykatës u zotua se, marrë parasysh se rezultatet në lidhje me komunikimin “ex parte” janë kaq të larta, duhet pasur kujdes të shtuar që ky komunikim të mos ndodh, meqë është shkelje e drejtpërdrejtë e kodit të etikës;
- Zyrtari për informim i kësaj gjykate, rekomandoj që komunikimi me publikun t'i përshtatet edhe kërkesave të qytetarëve, të cilët shumë më shumë vizitojnë faqen e gjykatës në Facebook se sa ueb faqen zyrtare;
- Kryetari i gjykatës shprehi se kontribuues tjetër në vonesat që ndodhin në procedimin e lëndëve është dy-gjuhësia e Gjykatës (aktualisht, Gj. Th. e Gjilanit ka gjashtë (6) gjykatës të nacionalitetit serbë dhe secili nga këta ka grupin e vet punues të cilët flasin vetëm gjuhën serbe. Kjo në vete nuk përbën problem, meqë gjuha serbe është njëra nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës. Mirëpo problem qëndron në faktin se për këta punëtorë të Gjykatës duhet të përkthehen të gjitha shkresat nga gjuha shqipe në atë serbe dhe kjo merr kohë të konsiderueshme;
- Zv. Kryetari i gjykatës u shpreh se ideale do të ishte sikur Këshilli Gjyqësor i Kosovës të kishte buxhetin e vet mbi të cilin do të kishte kompetenca ekzekutive në mënyre që të mënjanohet ndikimi politik në gjyqësor (Pra rritjen e rrogave dhe emërimin e gjykatësve do t'a bënte KGJK – plotësisht e pavarur).

Gj. Th. Mitrovicë:

- Pas transferimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë Veriore, integritet të gjykatësve serbë në sistemin e drejtësisë së Kosovës dhe përkthimit të lëndëve nga gjuha shqipe në atë serbe, Kryetari i Gjykatës u zotua se duhet bërë riorganizimi i punës brenda gjykatës, si dhe shfrytëzimi më i mirë i resurseve njerëzore, me qëllim të rritjes së efikasitetit;
- Kryetari i Gjykatës u zotua se duhet të krijohen rrugë përmes të cilave qytetarët lehtë mund të raportojnë rastet e korrupsionit. Kështu rekomandimet për kutia të ankesave dhe hapja e telefonave pa pagesë janë me vend.

- Gjithashtu, me qëllim të eliminimit të keqpërdorimeve eventuale, theks të veçantë u vu në përmirësimin e mënyrës se si mbledhen statistikat lidhur me rastet për të cilat raportojnë gjyqtaret. Ky raportim duhet të bëhet vetëm nga zyra për menaxhimin e lëndëve, pra duke mos i përfshirë gjyqtaret fare në këtë proces.

Gj. Th. Pejë & Gjakovë:

- Kryetarët e të dy Gj. Th. u zotuan se do të vendosin kutia të ankesave në objektin e gjykatës, ashtu që tu jepet mundësi qytetarëve të paraqesin ankesat e tyre lidhur me shërbimet e gjykatave në përgjithësi, por edhe në raportimin e sjelljeve të pahijshme si dhe korruptive nga ana e stafit të gjykatës.
- Te gjendet një mënyrë më e mirë e menaxhimit të vizitave nga avokatët të cilët pa leje hyjnë në zyrat e gjyqtarëve dhe kërkojnë informacione mbi rastet e tyre.

Gj. Th. Prizren

- Të kufizohet/ndalohet ardhja e avokatëve në gjykatë pa ftesa nga gjykata për të evituar komunikimin ex parte (Kryetari ka marrë këtë vendim në Gj.K. Prizren dhe rekomandon që gjykata edhe gjykatat tjera themelore të përcjellin një shembull të tillë);
- Kryetari i gjykatës u zotua se do t'i ndjek rekomandimet e raportit duke vendosur kutia të ankesave brenda objektit të gjykatës.

Gj. Th. Prishtinë

- Marrë parasysh volumin e punës të zyrtarit për informim të kësaj gjykate, si dhe rritjen e aktiviteteve të gjykatës në raport me informimin dhe komunikimin me publikun, z. Hoti premtoi rritjen e numrit të stafit në zyrën për informim;
- Nga shoqëria civile (organizata BIRN) propozoi që brenda mundësive ligjore, të ndalohet shtyrja e seancave në rastet kur ka mungesë të fletoreve, fletave/letrës e arsyeve tjera të ngjashme.
- Nga shoqëria civile (organizata BIRN) u rekomandua të shfuqizohet udhëzimi administrativ i KGJK-së për publikimin dhe anonimizimin e aktgjykimeve, meqë të dënuarit dënohen në emër të popullit, dhe nuk ka kuptim që t'u fshihen emrat.
- Po ashtu, u rekomandua që edhe publikimi i orarit të seancave të bëhet duke publikuar emrin e palëve në shqyrtim gjyqësor.
- Zyrtarja për informim nga Gjykata Supreme propozoi që mos t'u jepet pushim gjykatësve gjatë kohës kur kanë caktuar seanca për shqyrtim gjyqësor;

10 SHTOJCA 2

Pyetësor

Transparenca/Qasshmëria dhe Efikasiteti i Gjykatave Themelore në Kosovë

UDHËZIM: Jashtë gjykatore, numëruesi i terrenit i afrohet çdo personi të 5-ti person që del nga gjykata ku ka qenë për të mbaruar punë, si dhe vijon:

Mirëmëngjesi/mirëdita/mirëmbrëma, unë jam _____. Punoj si intervistues për organizatën Demokraci Plus, nën-kontraktuese e Programit të USAID-it për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë (JSSP). Jemi duke bërë një sondazh për të kuptuar se çfarë mendojnë qytetarët për efikasitetin dhe nivelin e transparencës së Gjykatave Themelore. A do të na falnit disa minuta për t'u përgjigjur në pyetje? Sondazhi është anonim si dhe të gjitha të dhënat do të paraqiten të grupuara, si dhe do të përdoren vetëm për qëllimet e këtij projekti.

DATA E INTERVISTËS			
KOHA E INTERVISTËS			
NUMRI I INTERVISTËS			NGA 100
KODI I RAJONIT 1 - PRISHTINA 2 - MITROVICA 3 - PEJA 4 - GJAKOVA 5 - GJILAN 6 - FERIZAJ 7 - PRIZREN			
GJINIA E RESPONDENTIT 1 - MASHKULLORE 2 - FEMËRORE			
GRUPMOSHA E RESPONDENTIT 1 - 18 – 24 vjeç 2 - 25 – 34 vjeç 3 - 35 – 44 vjeç 4 - 45 – 54 vjeç 5 - 55 – 64 vjeç 6 - 65+ vjeç			

Arsyeja pse respondenti ka shkuar në gjykatë?		
Q.1	<p>Grupi i shënjestruar: çdo i 5-ti person që del nga gjykata</p> <p>Pse keni ardhur sot në gjykatë?</p> <p>Nëse janë kodet 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 MOS VAZHDO me pyetësin..</p>	<p>1. Palë në procedurë – person fizik – duhet të marr pjesë PERSONALISHT (paditës apo i paditur)</p> <p>I.a. Nëse jeni palë, çfarë lloj rasti ju ka sjellë në gjykatë?</p> <p><input type="checkbox"/> Penal <input type="checkbox"/> Civil <input type="checkbox"/> Ekonomik</p> <p><input type="checkbox"/> Administrativ <input type="checkbox"/> Kundërvajtje <input type="checkbox"/> Me të mitur</p> <p>2. Avokat apo përfaqësues i autorizuar</p> <p>3. VETËM për shërbime administrative: dokumente, informata, pagesa, dhënia e deklaratës, etj.</p> <p>4. Dëshmitar</p> <p>5. Gazetar</p> <p>6. Vëzhgues/përkrahje të një të afërmi apo miku</p> <p>7. Gjyqtar, Bashkëpunëtor Profesional, ndihmës gjyqtar</p> <p>8. Prokuror, Bashkëpunëtor Profesional, prokuror praktikant</p> <p>9. Personel Administrativ</p> <p>10. Punoj në gjykatë, por jo në detyrë profesionale Të tjera (ju lutemi specifikoni):</p>
PYETJET PËR TRANSPARENÇË		
Përvoja që respondentit/ja ka në qasjen në gjykatë		
Q.2	Sipas përvojës tuaj, sa është e lehtë që të merrni informata nga gjykata për rastin tuaj?	<p>1. Tejet e vështirë</p> <p>2. Deri diku e vështirë</p> <p>3. As e vështirë as e lehtë</p> <p>4. Deri diku e lehtë</p> <p>5. Tejet e lehtë</p>
Q.3	A ishte e lehtë të gjeni gjykatoren apo zyrën që ju duhej?	<p>1. Tejet e vështirë</p> <p>2. Deri diku e vështirë</p> <p>3. As e vështirë as e lehtë</p> <p>4. Deri diku e lehtë</p> <p>5. Tejet e lehtë</p>
Q.4	Sa ishin të dobishme informatat që u janë dhanë nga gjykata?	<p>1. Tejet të padobishme</p> <p>2. Deri diku të padobishme</p> <p>3. As të dobishme e as të padobishme</p> <p>4. Deri diku të dobishme</p> <p>5. Tejet të dobishme</p>
Q.5	A e keni përdorur faqen e internetit të gjykatës?	<p>1. Po</p> <p>2. Jo</p> <p>Nëse është kodi 1, vazhdo tek 5a.</p>

Q. 5a	A keni gjetur atë që ju duhej?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nuk kam gjetur informatat që më duheshin 2. Kam gjetur krejt pak informata që më duheshin 3. Kam gjetur shumicën e informatave që më duheshin 4. Gjeta të gjitha informatat që më duheshin 	
-------	--------------------------------	--	--

PYETJET PËR EFIKASITET DHE TRAJTIM NË GJYKATË

Përvoja që respondentët kanë në marrjen e shërbimeve të gjykatës

Q.6	Sot kur ishit në gjykatë, a arritët që të kryeni punë në afat të arsyeshëm?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Fuqimisht nuk pajtohem 2. Nuk pajtohem 3. As pajtohem e as nuk pajtohem 4. Pajtohem 5. Plotësisht pajtohem 	
Q.7	Sa kohë është duke ju marrë zgjidhja e lëndës tuaj?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Më pak se gjashtë muaj 2. Deri në një vit 3. Deri në dy vjet 4. Më shumë se dy vjet 	
Q.8	A jeni trajtuar me mirësjellje dhe respekt?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Tejet i pakënaqur 2. Deri diku i pakënaqur 3. Asnjëra 4. Deri diku i kënaqur 5. Tejet i kënaqur 	
Q.9	A ju është dhënë mundësia që të përdorni gjuhën tuaj amtare?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Po 2. Jo 	
Q.10	A mendoni se rasti juaj është gjykuar në mënyrë të drejtë?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Po 2. Jo 3. Deri diku 	

PYETJET PËR PERCEPTIMIN E KORRUPSIONIT

Q. 11	Njerëzit kanë mendime të ndryshme mbi shkaqet e korrupsionit në gjyqësor. Për mendimin tuaj, cili është shkaku kryesor i korrupsionit? Ju lutemi të renditni arsyet vijuese prej 1-5, ku 1 është shkaku më i rëndësishëm, 2 është i dyti për kah rëndësia, 3 është i treti për kah rëndësia, 4 është i katërti për kah rëndësia, dhe 5 është shkaku më së paku i rëndësishëm.	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ndikimi politik 2. Ndikimi i palëve në proces 3. Motivimi financiar i gjyqtarit 4. Gjykata joefikase me resurse të kufizuara 5. Ndikimi i avokatëve 	
Q. 12	A ju është kërkuar ndonjë ryshfet nga ndonjë gjyqtar apo ndonjë punëtor i gjykatës?	<ol style="list-style-type: none"> 1. Po 2. Jo 	<p>Nëse PO, për çfarë arsye?</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për të përshpejtuar procedurat/procesin 2. Për të marrë dokumentin e kërkuar 3. Për të gjykuar në favorin tim 4. Të tjera

Q. 13	A keni dhënë ryshfet për ndonjë gjyqtar apo punëtor gjykate?	1. Po 2. Jo	Nëse PO, pyesni pse dhe çfarë pozite mban ai person? 1. Gjyqtar 2. Referent 3. Administratë 4. Tjetër	
Q. 14	Çfarë mendoni se do të mund të bëhet për të zvogëluar korrupsionin në gjyqësor?	PYETJE E HAPUR		
PYETJA PËRMBYLLËSE				
Q.15	Ju lutemi të mos ngurroni të na tregoni nëse keni ndonjë vërejtje apo vështrim, apo dëshironi të përmendni ndonjë aspekt tjetër gjyqësor që mund të jetë me rëndësi për përmirësimin e funksionimit të drejtësisë: (Keni ndonjë gjë për të shtuar?)	PYETJE E HAPUR		